



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**RAPORTI VJETOR I**  
**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA**  
**DISKRIMINIMI**

**VITI 2011**

**Tiranë, 22Shkurt 2012**

## **PËRMBAJTJA**

Fjala përshëndetëse e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

### **KAPITULLI I - VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

- 1.1. Komisioneri si institucion i barazisë dhe mosdiskriminimit
- 1.2. Vizioni dhe Misioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- 1.3. Raportime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- 1.4. Zhvillimi i kuadrit ligjor

### **KAPITULLI II – SITUATA AKTUALE E DISKRIMINIMIT**

- 2.1. Situata aktuale e diskriminimit sipas Raporteve Ndërkombëtare dhe raporteve organizatave të shoqërisë civile
- 2.2. Situata e diskriminimit në Shqipëri bazuar në monitorimin e KMD

### **KAPITULLI III – NDËRGJËGJESIMI**

- 3.1. Aspekte ndërgjegjësuëse në veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit
- 3.2. Trajnime për target grupe të veçanta
- 3.3. Konferenca të Komisionerit
- 3.4. Publikime dhe shpërndarja e materialeve
- 3.5. Komunikimi i zyrës me median

### **KAPITULLI IV - NGRITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË PUNONJËSVE TË ZYRËS SË KOMISIONERIT**

- 4.1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- 4.2. Seminare, Konferenca dhe Trajnime

### **KAPITULLI V - BASHKËPUNIMI ME AKTORËT QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E TYRE NË FUSHËN E DISKRIMINIMIT**

- 5.1 Bashkëpunimin Institucional
- 5.2 Bashkëpunimi me organizatat jo-fitimprurëse
- 5.3 Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare



## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

### **KAPITULLI VI - TRAJTIMI I ANKESAVE**

6.1 Veprimtaria konkrete e KMD bazuar ne ankesa

6.2 Çështje të ndjekura me iniciativën e KMD (“ex – officio”)

### **KAPITULLI VII – ASPEKTE TE SHERBIMEVE**

7.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Performancës

### **KAPITULLI VIII - STRATEGJIA PËR VITIN 2012 DHE PLANET PER PERIUHDHEN NE VAZHDIM**

8.1. Plani Strategjik 2012-2015 Dhe Plani I Veprimit Për Vitin 2012 I Komisionerit Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi Dhe Objektivat Strategjike Për Vitin 2012

#### **Shtojca Nr. 1**

Tabela me Fushat dhe Shkaqet e Diskriminimit

#### **Shtojca Nr. 2**

Rezultate e Monitorimit të realizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

#### **Shtojca Nr. 2**

Grafiket ne lidhje me veprimtarinë e Komisionerit bazuar ne Ankesa



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**Fjala përshëndetëse**

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

**Irma Baraku**

**E nderuar Zonja Kryetare e Kuvendit!**

**Të nderuar Deputetë!**

Ndjej një përgjegjësi të madhe që të paraqes raportin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që në mënyrë të vazhdueshme konsiderohet si një hap pozitiv dhe cilësor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në veçanti dhe për realizimin e proceseve intensive demokratizuese dhe integruese ku Shqipëria është përfshirë.

Dëshiroj të theksoj se gjithë aktiviteti i Komisionerit është zhvilluar në funksion të realizimit të këtyre proceseve dhe ushtrimit të kompetencave që ligji i ka përcaktuar si garant i mbrojtjes së subjekteve nga sjelljet diskriminuese apo që e nxisin atë.

Ky raport është konceptuar duke mbajtur parasysh detyrimin ligjor të Komisionerit për të paraqitur raport në Kuvendin e R.Sh. Më konkretisht, Neni 26 i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” thuhet shprehimisht se *“Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e komisionerit dhe të zyrës”*.

Përmbajtja e këtij raporti pasqyron pikërisht misionin dhe objektivat e Zyrës së Komisionerit të cilat shkojnë përtej vitit 2011, tashmë të reflektuara në dokumentin e miratuar nga institucioni, Plani Strategjik 2012-2015 dhe Plani i Veprimit për Vitin 2012 i Komisionerit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe në rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë ka adresuar për vitin 2011.

Shpresoj që ky raport të paraqesë interes për ligjvënësit, por edhe për të gjithë lexuesit.

**KOMISIONERE**

**Irma BARAKU**



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

**KAPITULLI I - VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM MBI KOMISIONERIN PËR  
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**1.1. KOMISIONERI SI INSTITUCION I BARAZISË DHE MOSDIKSRIMINIMIT**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është krijuar dhe funksionon në zbatim të Ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili është në përputhje me Direktivat e BE në fushën e mosdiskriminimit, ku përfshihen: Direktiva 2004/43/KE; Direktiva 2000/78/KE; Direktiva 2004/113/KE dhe Direktiva 2006/54/KE. Në këtë aspekt, miratimi i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është vlerësuar si hap pozitiv në procesin e përafrimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis* si dhe kuadri institucional për të drejtat e njeriut është përforcuar përmes krijimit të një organi të barazisë.

KMD, si institucion i posaçëm që garanton në nivel kombëtar promovimin, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë të individëve, gjithashtu ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me standartet europiane. Në këtë kontekst, theksojmë Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit European 2006/54/KE, në nenin 20 të së cilës parashikohet detyrimi i vendeve anëtare për ngritjen e organeve të barazisë të individëve. Në këtë nen parashikohen gjithashtu, edhe kompetencat kryesore që duhet të gëzojnë këto organe të barazisë dhe konkretisht:

1. Të ofrojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin;
2. Të kryejnë sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin;
3. Të publikojnë raporte dhe japin rekomandime për çdo çështje që lidhet me diskriminimin;

Kompetencat e KMD janë parashikuar në nenin 32 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Sipas parashikimeve të këtij neni, KMD gëzon një sërë kompetencash që shkojnë përtej parashikimeve të Direktivës 2006/54/KE. Në rast se do të kryenim një studim krahasues midis kompetencave të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe kompetencave të parashikuara në nenin 20 të Direktivës 2006/54/KE do të arrinim në klasifikimin e mëposhtëm:



## ***KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI***

- Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe që kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin:
  - të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;
  - të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi;
  - të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;
  - të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;
  - me kërkesën e gjykatës që shqyrton çështjen, të parashtojë mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
  - të përfaqësojë ankuesin në organet gjyqësore në çështje civile me miratimin e tij në përputhje me pikën 3 të nenit 34 të këtij ligji;
  
- Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe që kanë për qëllim kryerjen e sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin:
  - të kryejë sondazhe në lidhje me diskriminimin;
  - të monitorojë zbatimin e këtij ligji;
  
- Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe që kanë për qëllim publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin:
  - t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;
  - të publikojë raporte dhe të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
  - të kontribuojë në raportimet dhe sipas rastit të paraqesë raporte para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë;
  
- Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit:



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

- të nxisë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara;
- t'i drejtohet drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- të informojë për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;
- të zhvillojë dialogun e rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare;
- të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

KMD është person juridik publik i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij si dhe autoriteti përgjegjës në Shqipëri, i cili garanton mbrojtjen e subjekteve nga diskriminimi apo nga sjellje që nxit diskriminimin.

Kuadri ligjor mbi të cilin mbështetet organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e Komisionerit bazohet në Kushtetutën e R.Sh, legjislacionin e brendshëm dhe aktet ndërkombëtare që parashikojnë parimin e mosdiskriminimit.

### **1.2. VIZIONI DHE MISIONI I KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut është prioritet moral dhe politik i çdo shteti demokratik dhe përfaqëson një institut të rëndësishëm kushtetues dhe ligjor. Përveç kësaj, respektimi i të drejtave e njeriut mundëson një qasje njerëzore jo vetëm ndaj shtetit, ligjit, rendit publik, por edhe ndaj shoqërisë në përgjithësi, pasi pjekuria dhe zhvillimi i një shoqërie varet shumë nga statusi i të drejtave të njeriut, mbrojtja, respektimi dhe promovimi i këtyre të drejtave.

Në kuadër të këtij qëllimi të përgjithshëm dhe të qëllimit të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, vizioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me është:

***“Të jetojmë në një shoqëri ku respektohet parimi i barazisë dhe promovohet barazia e shanseve dhe mundësive”***



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në realizim të këtij vizioni, misioni i Komisionerit për vitet e ardhshme, *është mbrojtja nga diskriminimi i të gjithë personave të parashikuar nga ligji* përmes:

- Ofrimit të ndihmës së pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin;
- Rritjes së ndërgjegjësimit nëpërmjet informimit për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi, për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje dhe zhvillimit të dialogut të rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare;
- Kryerjes së sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin;
- Publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin;

### 1.3. RAPORTIME TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në nenin 26 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcaktohet detyrimi ligjor i Komisionerit për Raportime në Kuvendin e R.Sh ku thuhet shprehimisht se *“Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e komisionerit dhe të zyrës”*.

Duhet theksuar fakti se në hartimin e Raporteve Vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi shërbejnë edhe raportimet 3- mujore të KMD-së pranë Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, në Kuvendin R.SH.

Në përmbajtje të këtyre raportimeve, dërgohen informacion mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas prioriteteve dhe objektivave themelore të Zyrës për periudhën e raportimit. Në këtë kontekst, Komisioneri ka përgatitur raporte, përmbajtja e të cilave është fokusuar kryesisht tek struktura e institucionit dhe përmirësimi i saj, Aktivitete të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim ngritjen e kapaciteteve administrative të punonjësve të Zyrës së Komisionerit si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të subjekteve për ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndërmarra gjatë kësaj periudhë, aspekte ligjore dhe të shërbimeve, bashkëpunimi me aktorët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e diskriminimit.

Pas Raportit të Parë Vjetor të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për Vitin 2010, edhe pse i limituar në kohë raportuese, sepse Zyra e Komisionerit ka filluar funksionim në Qërshor të vitit 2010, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka nxjerrë në korrik të vitit 2011 *“Rezolutë për vlerësimin e punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi për vitin 2010”*, në të cilën vlerësohet, përgjithësisht, veprimtaria e Komisionerit në lidhje me:



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



## ***KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI***

- Përpjekjet e KMD për sensibilizimin dhe njohjen me Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe institucionin e Komisionerit;
- Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së Komisionerit me organet shtetërore, si dhe me institucionet jo-qeveritare dhe organizmat ndërkombëtare;
- Përkushtimin e Komisionerit për fillimin e funksionimit të institucionit dhe vendosjen e bazave të punës, sipas nivele europiane si dhe
- Përpjekjet e Komisionerit për të rritur performancën e stafit drejtues dhe plotësimin e kapaciteteve funksionale të tij.

Pas konstatimeve të mësipërme, Kuvendi i R.Sh kërkon përgjithësisht nga KMD që të kihet parasysh në ushtrimin e veprimtarisë së tij:

- Nxitja për një angazhim i plotë, intensiv dhe i efektshëm i mbrojtjes nga diskriminimi;
- Rritja e rolit sensibilizues për informimin e shtetasve, lidhur me misionin dhe kompetencat që ky institucion ushtron;
- Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me median e shkruar dhe vizive;
- Organizimin e veprimtarive në formatin “Ditë të hapura”, për të siguruar aksesin e nevojshëm të publikut, si dhe tryezave të rrumbullakëta, të hapura, për legjislacionin e barazisë kushtetuese dhe ligjore të shtetasve;
- Bashkëveprim dhe koordinim intensiv dhe periodik të Komisionerit me institucionet qeveritare në nivel qendror dhe vendor;
- Vendosjen dhe mbajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit të KMD-së me institucionet e tjera të pavarura, që kanë objekt fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe me institucionet akademike, shoqërinë civile, organizatat joqeveritare, organizatat ndërkombëtare që angazhohen të kontribuojnë në çështjen e mosdiskriminimit;
- Shtimin e kontributit në dhënien e mendimeve për aktet ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me çështjet e diskriminimit si dhe
- Metodologjia, mënyra e raportimit vjetor 2011 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të pasqyrojë një analizë të çështjeve, të fenomenologjisë dhe tipologjisë së tyre, si dhe përgjithësime mbi bazën e praktikave të kryera. Ky raport duhet të deklarojë zyrtarisht konkluzionin mbi gjendjen e respektimit të antidiskriminimit për vitin në vijim dhe të parashtojë rekomandime për proceset parandaluese dhe nevojat e mëtejshme për përmirësimin e punës për zbatimin e ligjit.

Këto çështje janë patur parasysh në objektivat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2011.

Në kuadër të procesit të integritimit European dhe angazhimit të qeverisë shqiptare për realizimin e këtij procesi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë kontributin e tij nëpërmjet



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

raportimeve të mëposhtme, duke bashkërenduar punën edhe me institucione të tjera shtetërore, kryesisht me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si dhe me Ministrinë e Integritit, si koordinatore e procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian:

Zyra e Komisionerit ka raportuar me datë 26 Maj 2011 në Takimin e Tretë të Nën-komitetit për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë BE - Shqipëri për Marrëveshjen e Stabilizim – Asociimit mbi pikën 6.3 “Politikat Anti- Diskriminim”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka raportuar me datë 30 qershor 2011 ka raportuar në takimin e III<sup>të</sup> të Nënkomitetit BE-Shqipëri mbi Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikat Sociale, në lidhje me Kapitullin 7. Bashkëpunimi Social, e cila përfshinte dy pika: 7.5 Përditësim i shkurtër mbi antidiskriminimin dhe mundësitë e barabarta, duke përfshirë miratimin e legjislacionit; 7.6 Asistenca financiare dhe koordinimi i ndihmës së huaj.

Në kuadër të adresimit të 12 Rekomandimeve të identifikuara në Opinionin e Komisionit Europian, është hartuar një plan veprimi nga secili prej institucioneve të përfshira në këto rekomandime. Ndërkaq që në fund të vitit 2011, u rishikua Plan i veprimit për plotësimin e 12 prioritetëve të Opinionit të Komisionit europian.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i përfshirë grupin e punës për përmbushjen e Rekomandimit 11 që i përket të Drejtave të Njeriut, konkretisht *“Të bëhen hapa konkretë në forcimin e mbrojtjes e të drejtave të njeriut, sidomos të grave, fëmijëve dhe romëve, si dhe në zbatimin e efektshëm të politikave anti-diskriminim”*, ka hartuar planin e tij të veprimit me masa konkrete dhe afatet kohore për përfundimin e tyre. Zbatimi i Planit të Veprimit monitorohet në mënyrë të rregullt me raportime mujore pranë institucioneve përgjegjëse.

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka raportuar në *Sesionin e 79-të të Komitetit Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, të mbajtur në Gjenevë në 22 - 23 Gusht 2011*. Raporti u prezantua nga delegacioni Shqiptar (Shteti Palë) pranë Komisionerit të Lartë të të Drejtave të Njeriut në Gjenevë në kuadër të *“Rishikimit të Raportit V-VIII Periodik Kombëtar të Republikës së Shqipërisë mbi Konventën Ndërkombëtare “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial”(CERD/C/ALB/5-8)*. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ishte pjesë e debatit ndëraktiv në lidhje me çështjet që parashtrori Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial, si: statusi, mandati dhe funksionimi i Zyrës së Komisionerit; burimet financiare; kompetencat e Komisionerit; risitë e ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* si dhe përputhshmëria e tyre me kriteret e parashikuara nga Parimet e Parisit të miratuara me Rezolutën 48/134 datë 20.12.1993 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara; mbrojtja nga diskriminimi indirekt si dhe



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

forma te tjera të Diskriminimit të parashikuara në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në kontekstin e zhvillimeve praktike të Zyrës së Komisionerit, Komiteti shfaq interes edhe mbi aktivitetet e zhvilluara nga Zyra e Komisionerit në kuadrin e mbrojtjes nga diskriminimi racial, fushata sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere me qëllim përmirësimin e zbatimit të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe njohjen e komunitetit me garancitë që iu ofrohen si dhe bashkëpunimi institucional me grupet apo shtresat e prekura, kryesisht nga diskriminimi racial.

### 1.4. ZHVILLIMI I KUADRIT LIGJOR

Në strukturën e institucionit të Komisionerit është parashikuar *Drejtoria e Çështjeve Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënive me Jashtë*, që ka si objekt të veprimtarisë së saj, ndër të tjera, hartimin e projekt-akteve të KMD-së në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, ndjekjen e procesit të shqyrtimit, konsultimit dhe miratimit të projekt-akteve; përgatitjen e mendimeve juridike për të gjitha projekt-aktet e dërguara në adresë të zyrës së KMD dhe përgatitjen e materialeve, raporteve, rekomandimeve dhe studimeve të ndryshme të KMD. Bazuar në këto funksione dhe kompetenca, zhvillimi i kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi ka konsistuar në këto çështje:

Zyra e Komisionerit ka vlerësuar çdo akt ligjor dhe nënligjor të ardhur për mendim në institucionin tonë duke dhënë mendime ligjore që i përkasin fushës së diskriminimit. Në këtë aspekt, Komisioneri ka dhënë mendim ligjor në lidhje me Ligjin “Për Regjistrimin e Popullsisë”, pas kërkesës së Komitetit Shtetëror të Minoriteteve si dhe projekt-ligjin “Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Në lidhje me këtë të fundit rekomandimet e Komisionerit, që synojnë respektimin e parimit të barazisë, janë marrë parasysh që në fazat e para të konsultimit të këtij projekt-ligji. Opinioni i komisionerit për këtë çështje është kërkuar edhe përpara se projekt-ligji të kalojë në Këshilline Ministrave në Janar 2012.

Komisioneri ka dhënë mendimin juridik në lidhje me Reagimin e Komunitetit Maqedonas kundër Vendimit nr. 52 datë 01.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë për heqjen e termit të “kombësisë” nga Ligji nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”. Në lidhje me këtë çështje, Komisioneri ka theksuar se do të kërkojë në çdo rast respektimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore si dhe respektimin e parimit të trajtimit të barabartë të pakicave kombëtare si garanci kushtetuese dhe qasje të parimit të mosdiskriminimit, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës dhe në Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Fakti është se Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe kanë fuqi detyruese të përgjithshme. Në këtë kuadër, qëndrimi i vetëm institucional që mund të mbajë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është orientimi drejt mundësisë së vetme të ankimit të kësaj çështje në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Zyra e Komisionerit është pjesë e grupit të punës për përmirësimin e legjislacionit për Personat me Aftësi të Kufizuar, me qëllim hartimin e një ligji integral për Personat me Aftësi të Kufizuar, bazuar në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollin e saj Opsional.

Zyra e Komisionerit është pjesë e grupit të punës që ka për qëllim hartimin e një plani masash për personat me orientim të ndryshëm seksual. Në zbatim të Urdhërit nr. 55 datë 14.04.2011 të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për ngritjen e grupit të Punës për Hartimin e një plani masash duhet veprimi për personat me orientim të ndryshëm seksual”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë në takimet e vazhdueshme të grupit të punës. Objektivat e përcaktuara për këtë qëllim kanë të bëjnë me këto çështje kryesore: - Rishikimi i legjislacionit brenda kuadrit që mbulon MPCSSHB dhe që ngarkon ligji nr. 10 221 date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për t’ju ofruar mbrojtje ligjore personave me orientim të ndryshëm seksual. – Kryerja e një vrojtimi kombëtar mbi situatën e personave me orientim të ndryshëm seksual. – Hartimi i një Plan Veprimi me masa konkrete në mbështetje të personave me orientim të ndryshëm seksual. Ky bashkëpunim vijon ende në janar - shkurt 2012 për qëllimet e të cilit janë zhvilluar disa takime me Keshllin e Europës.

Gjithashtu, KMD është i përfshirë në grupin ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët 2011-2015 dhe Planit të saj të Veprimit. Në këtë aspekt, Zyra e KMD ka kontribuar në dërgimin e komenteve dhe sugjerimeve mbi vlerësimin e Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve 2005- 2010 si dhe mendime mbi aspekte të rishikimit të kësaj të fundit, meqenëse kjo Strategji do shërbejë si bazë për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve 2011- 2015 si dhe Planit të Veprimit për Fëmijët 2011-2015. Së fundmi, është zhvilluar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me datë 4 Nëntor 2011 një aktivitet me qëllim prezantimin e Draft Planit të Veprimit 2011-2015 të Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve, si dhe diskutimin me pjesëmarrësit (grupin e punës që ka kontribuar në hartimin e këtij Drafti të Avancuar), institucionet e tjera publike dhe shoqërinë civile.

Në lidhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2011 - 2013, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë kontributin e saj në dërgimin e mendimeve dhe sugjerimeligjore, veçanërisht në aspekt të përfshirjes së standardeve ligjore kundër diskriminimit.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## KAPITULLI II

### SITUATA AKTUALE E DISKRIMINIMIT

#### 2.1. SITUATA AKTUALE E DISKRIMINIMIT SIPAS RAPORTEVE NDËRKOMBËTARE DHE RAPORTEVE ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Në ushtrim të kompetencës për të raportuar mbi situatën e diskriminimit në Shqipëri, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka hartuar matricën e grupeve vulnerabël.<sup>1</sup>

Në gjetjen e fushave dhe shkaqeve të diskriminimit janë marrë në konsiderate rekomandimet e dhëna për Shqipërinë gjatë viti 2010-2011 në: Progres Raportet, Raportet nga organizatat ndërkombëtare dhe ato rajonale të cilat monitorojnë implementimin e Konventave me objekt mbrojtjen e të drejtave të njeriut ku Shqipëria është palë, si dhe raporte hije të OJF-ve Shqiptare.

Gjetjet kryesore janë të pasqyruara si më poshtë:

#### **Diskriminim në fushën e punësimit për shkaqe të:**

**Racës-** Numri i Romëve të papunë mbetet ende i lartë dhe vuajnë nga papunësia afatgjatë. Mungesa e aksesit në punësim është si pasojë e mos arsimimit dhe vendosja e tyre në rajone të varfra.<sup>2</sup>

**Gjinisë** - Hendek i gjerë i pagave midis gjinive, skemat në mbështetje të grave që kanë për të shlyer detyrime pune dhe familjare janë të pazhvilluara. Gjithashtu, janë shqetësuese ngacmimet seksuale dhe mundësia jo e barabartë në fushën e punësimit për gratë dhe burrat.<sup>3</sup>

**Aftësisë së kufizuar-** Gratë janë edhe më shumë të privuar në fushën e punësimit. Nuk ka kuota për punësim e tyre dhe mungon infrastruktura.<sup>4</sup> Niveli i përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës mbetet shumë i ulët dhe kuotat e prezantuara nga ligji për nxitjen e punësimit, përgjithësisht nuk zbatohen.<sup>5</sup>

**Moshës** - Punësimi i fëmijëve mbetet një çështje që përbën shqetësim serioz.<sup>6</sup>

#### **Diskriminim në fushën e arsimit për shkak të :**

**Racës** - Romët ende përballen me kushte shumë të vështira jetese dhe diskriminimi të shpeshtë, veçanërisht në lidhje me aksesin në arsim.

<sup>1</sup> Për më shumë shih Shtojcën Nr .1

<sup>2</sup> Raporti i ERCI 2010

<sup>3</sup> Raporti CEDAW 2010

<sup>4</sup> Raport-Hije të OJF-ve shqiptare për CEDAW '2010

<sup>5</sup> Progres Raportit 2010

<sup>6</sup> Raporti 2010 i ECRI

## ***KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI***

Niveli i regjistrimit parashkollor për fëmijët romë vazhdon të jetë më i ulët në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë.<sup>7</sup>

Braktisja e shkollës nga Komuniteti Rom para kalimit të moshës ligjore është ende i lartë, gjithashtu kjo i bën ata të ndjeshëm për viktime trafikimi.<sup>8</sup>

Gëzimi i të drejtave në mënyrë efektive në arsim nuk është i garantuar për të gjithë fëmijët që i përkasin minoriteteve dhe grupeve të tjera vulnerabel, shumica e të cilëve nuk kanë akses në arsimimin në gjuhën e tyre.<sup>9</sup>

Ka më shumë ndëshkime kundrejt fëmijëve Rom sesa nxënësve të tjerë; Nxënësit Rom janë shënjestër e fyerjeve raciste; Nxënësit Rom e Egjiptian ulen në bankat e fundit të klasave.<sup>10</sup>

**Gjinisë-** Duhet rritur masat e posaçme në vend për të siguruar përfaqësimin e grave në nivele të larta drejtuese në institucionet arsimore.<sup>11</sup>

### **Diskriminim në fushën e strehimit për shkak të:**

**Racës-** Romët jetojnë në kushte të vështira jetese dhe janë të pa strehë.<sup>12</sup>

### **Diskriminim në fushën e shëndetësisë për shkak të:**

**Racës-** Jo të gjithë fëmijët Rom janë vaksinuar . Gjithashtu inkurajohen autoritetet shqiptare për të ulur pabarazinë në kujdesin shëndetësor të Romëve për të rritur aksesin e tyre në kujdesin shëndetësor primar.<sup>13</sup>

**Gjinisë-** Mbetet shqetësim, pabarazia në aksesin e grave për kujdes shëndetësor në zonat rurale në krahasim me zonat urbane dhe stigmatizimi e përjashtimi shoqëror i grave me HIV/AIDS.<sup>14</sup>

### **Diskriminim në fusha të ndryshme me shkak:**

**Racën-** Mungon ende regjistrimi zyrtar për Komunitetin rom; Ata vijojnë fyerje raciste në ambientet shkollorë; Pjesëmarrje e Komunitetit Rom në procesin e vendim-marrjes është shumë i ulët.<sup>15</sup>

**Gjininë-** Gratë vuajnë nga dhuna në familje; Kuota gjinore nuk është respektuar në të gjithë vendin në zgjedhjet lokale në Maj 2011.<sup>16</sup>

<sup>7</sup> Progres Raportit 2011

<sup>8</sup> Raporti ERCI 2010

<sup>9</sup> Raporti i CERD 2011

<sup>10</sup> ECRI 2010

<sup>11</sup> Raporti CEDAW 2010

<sup>12</sup> Raportit të ECRI 2010, Progres – Raport 2011

<sup>13</sup> Raporti i ECRI 2010

<sup>14</sup> Raportit CEDAW 2010

<sup>15</sup> Raportit 2010 ECRI





## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Përben shqetësim që prostitutat dhe viktimat e trafikimit mbeten ende subjekt i ndëshkimeve penale, sipas Kodit Penal të R.Sh.<sup>17</sup>

**Orientimin seksual dhe identitetin gjinor-** Homofobia mbetet e përhapur tek njerëzit, duke përfshirë këtu edhe nëpunësit e shërbimit civil. Ushtrim i dhunës dhe keqtrajtimit kundrejt komunitetit transgjitor.<sup>18</sup>

**Aftësinë e Kufizuar:** Individët që vuajnë nga aftësia e kufizuar mendore akoma nuk kanë një status zyrtar.<sup>19</sup>

### 2.2. SITUATA E DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI BAZUAR NË MONITORIMIN E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në zbatim të planit të punës dhe kompetencave kryesore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 10 221, dt. 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, *kryerjen e sondazheve në lidhje me diskriminimin, publikimin e raporteve dhe bërjen e rekomandimeve për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*, Komisioneri konsideroi të nevojshme të zhvillojë një *monitorim me fokus sjelljet diskriminuese në sistemin arsimor dhe niveli i njohjes së ligjit nr. 10 221, dt. 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Këto kategori janë përfshirë në këtë iniciativë për arsye se ata janë grupe sociale me statuse të ndryshme shoqërore si dhe i përkasin grupmoshave, racave, gjinive, feve, kulturave, përkatësive dhe bindjeve të ndryshme. Gjithashtu, këto grupe bashkëveprojnë ndërmjet tyre në institucionet arsimore. Të gjithë këta aktorë dhe faktorë mund të influencojnë në krijimin e një klime të përshtatshme për të luftuar diskriminimin, duke bashkëpunuar dhe koordinuar ndërmjet tyre përpjekjet e tyre në këtë fushë. Kjo përpjekje e organizuar nga Komisioneri u përqendrua kryesisht në aspekte sasiore dhe cilësore që lejojnë dhe mundësojnë një pamje sa më të gjerë të shfaqjes së problemit të diskriminimit në ambientet shkollorë dhe sa është trajtuar ky problem nga drejtuesit e shkollave, mësuesit dhe psikologët me nxënësit.

Natyrisht interesimi i gjithë faktorëve dhe aktorëve politik, social për çështjen e diskriminimit në shoqëri ka ardhur gjithnjë në rritje për shkak të ndërgjegjësimin të një pjese gjithnjë e më të madhe të popullsisë.

Në këtë kontekst studimi i paraprin masave dhe hapave të mëtejshëm që do të ndërmerri Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjithashtu do të plotësohet procesi i njohjes dhe

<sup>16</sup> Raport Hije i OJF-ve Shqiptare për CEDAW

<sup>17</sup> Raport 2010 CEDAW

<sup>18</sup> Progres Raport 2011

<sup>19</sup> Progres Raport 2011



## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

vlerësimit të situatës, duke përcaktuar detyra të natyrës politike e sociale për të gjithë faktorët dhe aktorët që kanë rol dhe përgjegjësi për nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Në studimin e paraqitur do të analizohen në mënyrë të qartë dhe më të saktë gjendja aktuale e diskriminimit në ambientet shkollore dhe masat që janë marrë duke dhënë në këtë mënyrë ecurinë e dukurisë dhe të shkaqeve kryesore që sjellin diskriminimin e disa grupeve apo personave, duke synuar të identifikohen mundësit e ndërhyrjes. Identifikohen fushat për ndërhyrje dhe do të formulohen rekomandime për politikën, programet dhe masat për zgjidhjen e problemeve dhe sfidave.

Natyrisht, problemi i luftës kundër diskriminimit është kompleks dhe në thelbin e vet, ka të bëjë me të drejtat e njeriut.

### ***Qëllimi i këtij monitorimi ishte:***

1. Te nxjerr një pasqyre sa më reale të nivelit të njohjes së ligjit nr. 10 221, dt. 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ***nga nxënësit e grupmoshave 12-18 vjeç.***
2. Te nxjerr një pasqyrë sa më reale të nivelit të njohjes së ligjit nr. 10 221, dt. 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe të detyrimeve që ligji parashikon për ***drejtuesit e institucioneve arsimore:***
  - ***rritja e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda institucionit, ndër të tjera duke afishuar ligjin në një vend të dukshëm;***
  - ***lufta kundër modeleve të sjelljes diskriminuese që përbëjnë ose nxisin diskriminim brenda institucionit;*** etj
3. Të nxjerre një pasqyre sa më reale të ekzistencës së fenomenit të diskriminimit, të llojeve kryesore të shkaqeve diskriminuese dhe mënyrës së trajtimit të tyre në sistemin arsimor për grupmoshat e sipërpërmendura
4. Bazuar në të dhënat e monitorimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të dalë me rekomandime specifike lidhur me diskriminimin në fushën e arsimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vazhdimësi të fushatës së ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin, nëpërmjet këtij monitorimi, iu drejtua sistemit arsimor ku përfshihen shkollat 9-vjeçare dhe të mesme publike e jopublike, duke bërë përpjekjen e parë për të vlerësuar situatën e diskriminimit në Shqipëri.

Në mënyrë që të arriheshin objektivat e monitorimit, duke u bazuar në eksperiencat e mëparshme të aktiviteteve të Komisionerit, ku është vërejtur mungesa e njohjes së ligjit dhe e institucionit të Komisionerit nga punonjësit e sistemit arsimor e aq me pak nga nxënësit e shkollave, u mendua



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

që shkollat që monitorohet të pajisen me disa materiale që do të përgatiten për shpërndarje, si: broshura informuese për Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe Zyrën e Komisionerit, ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, formularë të ankesës pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Një nga arsytet pse u jemi drejtuar këtyre grupeve është se vetë ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon si një ndër fushat që gëzojnë mbrojtjen e këtij ligji, fushën e arsimit. Natyrisht që fushat e parashikuara në ligj nuk janë shteruese por fakti është që ligjvënësi ka parashikuar fushën e arsimit duke parë rëndësinë e rritjes së një brezi të ri pa paragjykimë dhe sjellje diskriminuese, duke iu drejtuar konkretisht këtyre grup moshave:

1. Nxënësve të grup-moshës 12-15 vjeç
2. Nxënësve të grup-moshës 16-18 vjeç
3. Mësuesve dhe psikologeve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme
4. Drejtuesve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme.

Monitorimi u krye në Bashkitë: Shkodër, Tiranë, Elbasan, Durrës, Fier, Kukës dhe u shtri në 6 shkolla për secilën bashki.

Gjithashtu janë organizuar takime me drejtues të shkollave, të cilëve u është kërkuar informacion që ato kanë mbi problematikat me grupet me vulnerabel (*me numrin e nxënësve të komuniteteve rom, egjiptian, me aftësi të kufizuara etj*) si dhe përpjekjet që janë bërë nga drejtoritë e shkollave për t’u përballur me këto problematika. *Gjithashtu është parë nëse drejtuesit kanë ndërmarre veprime konkrete për të përmbushur detyrimet që parashikohen sipas nenit 19 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.*

Janë ngritur disa grupe pune të cilat mbuluan procesin e shpërndarjes dhe të mbledhjes së pyetësorëve nëpër bashki.

***Pa filluar akoma analiza e të dhënave u arritën disa konkluzione paraprake lidhur me detyrimet që ligji parashikon për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e arsimit:***

1. Në asnjë nga shkollat nuk ishte afishuar ligji në vendet e dukshme në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit siç edhe është parashikuar në nenin 19 pika a, të ligjit.
2. Nuk u gjet ndonjë kënd apo mjet tjetër që mund të përdorej për të bërë të mundur njohjen nga nxënësit dhe mësuesit me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

3. Nuk na u dha ndonjë rast konkret diskriminimi e shqyrtuar nga drejtuesit e institucioneve. Nuk kishin pasur ndonjë kërkesë për shqyrtimin e ankesës për diskriminim bazuar në parashikimet ligjor, siç është parashikuar ne nenin 19 pika ç,d te ligjit.

Sa më sipër, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi ka dalë me rekomandime konkrete drejtuar institucioneve arsimore:

1. Drejtoria arsimore rajonale te marre te gjitha masat për te përmbushur detyrimet qe parashikon Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ne kreun III te tij, duke u ndalur kryesisht ne parashikimet ligjore te nenit 19 i cili parashikon:
  - Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Masat që merren, ndër të tjera, janë:
    - a) rritja e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda institucionit, ndër të tjera duke afishuar ligjin në një vend të dukshëm;
    - b) lufta kundër modeleve të sjelljes diskriminuese që përbëjnë ose nxisin diskriminim brenda institucionit;
    - c) të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dënjës;
    - ç) trajtimi efektiv i ankesave për diskriminim në institucion, duke shqyrtuar çdo ankim brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij;
    - d) vendosja e masave disiplinore ndaj çdo personi që verifikohet të ketë kryer një veprim diskriminues kur një gjë e tillë është e përshtatshme, proporcionale dhe në përputhje me kompetencat e drejtorit.

Në përputhje me nenin 33, pika 11 të Ligjit nr. 10 221, date 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

### **REZULTATI I ANKETIMIT**

- a. Analiza nga pikëpamja e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 për Mbrojtjen nga Diskriminimi të anketave.

E theksuam edhe më lartë që gjatë fazës së ndarjes dhe plotësimit të anketave në shkolla u vu re dhe u arrit në disa konkluzione paraprake. Me rezultatet e dala nga pyetësorët ne vërejmë:



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

1. Puna e psikologut ( kjo e shprehur dhe nga vetë nxënësit dhe mësuesit) nuk bazohej në strategji konkrete por funksiononte duke u nisur nga “spontaniteti” i situatës.
2. Nga anketimi i mësuesve por as nga drejtuesit e shkolla nuk na rezulton asnjë plan masash të marra.
3. Mësuesit nuk argumentojnë në anketë asnjë situatë dhe mënyrën e veprimit në një rast konkret.
4. Mësuesit dhe psikologët në anketë shprehin se situata është zgjidhur vetëm mes bisedave.
5. Nuk kemi pothuajse asnjë masë dhe strategji të ngritur në shkolla për fenomenin e diskriminimit por dhe asnjë masë të marrë për rastet e paraqitura.
6. Nuk vërejmë asnjë sensibilizim apo ndërgjegjësim të nxënësve për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për llojet e tij dhe shkaqet. Vëmë re se dhe mësuesit në masën më të madhe janë të informuar nga media dhe interneti për ligjin dhe në % shumë të vogël nga drejtuesit e tyre.
7. Drejtuesit e shkollave nuk japin asnjë raste ose masë konkrete.

Vërejmë se kur kërkojmë shkaqe për rastet e diskriminimit në ambientet e shkollave, mësuesit në përgjithësi nuk japin shkaqe të diskriminimit. Ndërsa, një pjesë e tyre theksojnë se si shkaqe kryesore të diskriminimit në ambientet e shkollës janë:

- Gjendja ekonomike,
- Bindjet politike
- Vendbanimi

Ndërsa, nxënësit rendisin si shkaqe kryesore të diskriminimit të shfaqura në ambientet shkollore, këto të mëposhtmet:

- Raca
- Vendbanimi
- Orientimi seksual
- Ngjyra
- Gjendja ekonomike
- Mosha
- Gjinia
- Aftësi e kufizuar

Mësuesit theksojnë se nga migrimi nga njëra zonë në tjetrën mes nxënësve shpeshherë shfaqen situata diskriminuuese për shkak të shoqërizimit. Ka raste “SHQETËSIMI”- Cenimin e Dinjitetit mes nxënësve, por në anketë ato edhe pse pretendojnë se ka raste të tilla nuk shprehin asnjë masë që mund dhe duhet të marrë vetë shkolla dhe drejtuesit e shkollave.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Gjithashtu vlen për tu theksuar se në të gjithë bashkitë ku është zhvilluar anketimi mësuesit pretendojnë se diskriminohen nga nxënësit dhe që janë këto dhe prindërit e tyre që diskriminojnë.

Një sensibilizim më i dukshëm është në Tiranë por gjithsesi shohim se masat nuk janë konkrete dhe kjo reflektohet dhe te nxënësit.

### **b. Analizë sociale e pyetësorëve**

Duke u ndalur në një analizë më sociale të anketave dhe shtrirjes që ato kanë pas anketimi dhe rezultatet që kanë dal nga ai duhen parë në një kontekst social shumë më të gjerë.

Përball ligjit kemi një formim psiko-kulturor të nxënësve dhe të mësuesve që ndikon shumë në mënyrën se si plotësojnë anketën dhe si sillen ndaj saj.

Në shkollat ku është zhvilluar anketimi shpeshherë tek mësuesit vërehej një tërheqje për të thënë situatën ashtu siç është dhe në % shumë të madhe aty ku ne kemi kërkuar shpjegime nga mësuesit ato nuk janë përgjigjur.

Vetëm në disa raste ato shkruajnë se “përdoren në shkollë fjalë me nënkuptime, ka aktivizim të disa mësuesve dhe të tjerë që nuk aktivizohen në aktivitete”. Edhe tek nxënësit shpesh ndeshet pjesëmarrja në aktivitetet shkollore vetëm e një numri të kufizuar nxënësish duke pretenduar në një % të madhe diskriminim të tërthortë.

Duke analizuar anketat e mësuesve dhe të nxënësve nuk na paraqitet dhe nuk ka asnjë strategji që tregon si veprohet me situata të ndryshme diskriminimi që mund të shfaqen në ambientet e shkollave.

Duke e parë nga një këndvështrim psiko-social dhe kulturore vëmë re se mësuesit nuk shprehen hapur dhe nuk i thonë problemet ashtu siç janë duke pasur frikën ose duhet thënë duke mos pasur informacionin e nevojshëm. Kjo sjell dhe një marsh gabimi dhe rezerve në anketim.

Nga një këndvështrim tjetër na bën të reflektojmë për masat që duhen marrë në të ardhmen dhe mënyrën e ndërhyrjes.

Duke u ndalur në disa pyetje të veçanta theksojmë:

Pyetjes si e përkufizoni ju diskriminimin? Mësuesit janë përgjigjur në mënyra të ndryshme, shikohet një përkufizim jo i plot dhe i qartë që ato japin.

Në këtë mënyrë ne vëmë re se vetë mësuesit e kanë të vështirë ti drejtojnë dhe ti shpjegojnë nxënësve në mënyrë të qartë diskriminimin dhe ajo që është më e rëndësishme të kuptojnë rastet e diskriminimit dhe të marrin masa për parandalimin e këtyre rasteve.

Përgjigjet që ne kemi marrë janë: Një formë veçimi, pabarazi, shkelje e të drejtave, fyerje, paragjykim, përcmim, mohim i lirisë, mosvlerësim në punë, mospërfillje, përbuzje, mospërkrahje, qëndrim jo tolerant. (këto janë shprehje të mësuesve dhe nuk kanë asnjë shpjegim prej tyre në anketë.) Vihet re një njohje jo e qartë e diskriminimit pozitiv ku disa mësues shprehen se pamja jashtme ose përdorimi i fjalëve fyese është një “diskriminim pozitiv” një mësuese shprehet:”të të thonë bëju i bukur pse je jo i bukur është një gjë që nuk quhet diskriminim”. (Shprehja është marrë siç është e shkruar në anketë).



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Shohim dhe nga grafikët se dhe në anketat e nxënësve dhe ato të mësuesve në 70% pretendojnë se nxënësit diskriminohen mes njëri-tjetrit kjo është një tregues që roli i shkollës gjithashtu i familjes është i vogël. Institucioni arsimor nuk e luan rolin e saj ashtu siç duhet dhe ndërhyrjet nga ana e mësuesve dhe psikologëve kanë qenë minimale. Kjo e fundit del dhe nga grafiku i përgjigjeve të mësuesve ku ne në asnjë moment nuk na është dhënë një plan pune apo strategji për luftën kundër diskriminimit. Në të gjashtë shkollat e çdo qyteti shohim një indiferencë në plotësimin e anketave ku në 80% pyetjeve të hapura mësuesit nuk i janë përgjigjur.

Një problem që del nga anketat në qytetin e Elbasanit është me nxënësit rom mësuesit pranojnë që situata nuk është e thjeshtë. Por nuk na parashirojnë ndonjë masë që mund të ketë marrë shkolla. Një mësuese shprehet: "shpesh nxënësit mundohen të rrinë larg nxënësve me ngjyrë, nuk pranojnë të ulen në një bankë" nga mësuesit pranohet fakti që kjo situatë shkaktohet nga prindërit sepse janë këto të fundit që i mësojnë fëmijët dhe i udhëzojnë që mos të rrinë me nxënës rom. Po kështu edhe pse në përqindje të vogël nxënësit theksojnë se ato nuk trajtohen njësoj në klasë apo në aktivitete jashtë shkollore sepse aty mund të ketë fëmijë që janë të privilegjuar ose me prindër me "emër të madh" në qytet dhe kjo ndjehet nga nxënësit por në 2% është e shprehur edhe nga mësuesit.

Format e diskriminimit që hasim më shpesh në shkollat e anketuara duke u nisur nga një analizë sociale janë: **Përrjashtimi nga një grup** ( Përrjashtimi i pakicës nga shumica, me qëllim forcimin e pozitës së shumicës); **Mobbing** ( përrjashtimi i një personi duke e paraqitur atë si "dele e zezë". Forma më e keqe e diskriminimit sepse ndodh në veprim kolektiv kundër një personi); **Vlerësim në bazë të pamjes; Agresion verbal/ Ofendime** (diskriminim gjuhësor mund të shkaktojë ofendime të hapura, fjalë ofenduese dhe poshtëruese).



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

**KAPITULLI III**  
**NDËRGJËGJESIMI**

**3.1. ASPEKTET NDËRGJËGJËSUESE NË VEPRIMTARINË E ZYRES SË KMD**

Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2011, ka qenë zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese që ndihmojnë në njohjen dhe zbatimin e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” me qëllim informimin për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje në Shqipëri.

Hap i rëndësishëm në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese është publikimi i faqes zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi [www.kmd.al](http://www.kmd.al) në Maj 2011, mundësuar nga OSBE Prezenca në Shqipëri. Subjektet e interesuar mund të marrin informacion nëpërmjet Web-it zyrtar të KMD në lidhje me bazën ligjore, veprimtarinë dhe aktivitetet e Zyrës, publikime, kontakte si dhe formularin e ankimit të cilin mund ta gjejnë edhe në anglisht, dhe në gjuhët e pakicave, greqisht dhe rumanisht. Ajo që vlen të theksohet është se krijohen lehtësi për të garantuar mbrojtjen nga sjelljet diskriminuese duke iu drejtuar Komisionerit përmes mënyrës së ankimit on-line, printimit të formularit dhe dërgimit me poste, fax apo e-mail. Gjithashtu në faqe e Web, gjenden edhe materiale të tjera informuese si Broshurat, Fletpalosje.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me mbështetjen financiare të OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, ka zhvilluar më datë 11 Prill, aktivitetin me temë “*Diskriminimi: Perceptimi dhe sfidat aktuale*”. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte rritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen nga diskriminimi të nxënësve, mësuesve dhe shoqërisë në përgjithësi. Ky aktivitet ishte pjesë e projektit të Prezencës së OSBE në Shqipëri “Parandalimi dhe lufta kundër diskriminimit në Shqipëri” dhe ishte i lidhur drejtpërdrejtë me objektivat e Komisionerit për promovimin e ligjit dhe të institucionit, si dhe edukimin e sensibilizimin e mësuesve dhe nxënësve të shkollave 9 – vjeçare për luftën kundër diskriminimit. Gjatë këtij aktiviteti, u përurua një ekspozitë në arte figurative dhe krijime letrare nga 30 nxënës të përzgjedhur nga 6 shkolla të kryeqytetit. Ndërkaq, në pjesën e dytë të aktivitetit, u referuarn 3 punime nga ekspertë të zgjedhur në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. I pranishëm ishte dhe Ambasadori i OSBE Tiranë, Z. Eugen Wollfarth i cili përshëndeti krijimin e Zyrës dhe vuri theksin në mënyrat e zvogëlimit të diskriminimit në shkolla.

Në ditën Ndërkombëtare kundër Diskriminimit Racial, që përkon me datën 21 Mars 2011, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka zhvilluar, në ambientet e KMD, një takim me





## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

përfaqësues të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Qëllimi i këtij takimi fillimi i bashkëpunimit me këto organizata si dhe ndërgjegjësimi i tyre për t'iu drejtuar Komisionerit në rastet kur ata pretendojnë shkelje të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Pjesëtarët e këtyre minoriteteve u ftuan që në të ardhmen të bashkëpunojnë me këtë Zyrë në mënyrë që ligji të implementohet dhe problemet, shqetësimet dhe ankesat e këtyre grupeve vulnerabël të evidentohen dhe të merren masa për mbrojtjen sa më efektive nga çdo formë e diskriminimit.

Në kuadër të projektit “Përmirësimi i zbatimit të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i mbështetur financiarisht nga Civil Rights Defenders (CRD), Komiteti Shqiptar i Helsinkit në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kanë zhvilluar 5 seminare ndërgjegjësuese nga data 23-25 mars 2011 në shkollat e mesme, universitetet publike dhe ato private në qytetin e Sarandës, Vlorës dhe Gjirokastrës. Trajnimet u zhvilluan nga një përfaqësuese e KShH dhe një përfaqësuese e KMD, të cilat u përqendruan përkatësisht në përmbajtjen e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe prezantimin e Zyrës së Komisionerit. Qëllimi i këtyre seminareve ishte informimi dhe sensibilizimi pjesëmarrësve në lidhje me ekzistencën dhe përmbajtjen e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka bashkëpunuar me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë, duke realizuar një sesion informimi në lidhje me Ligjin “Për Mbrojtje nga Diskriminimi”, me 3 Mars 2011, në zyrat e EUIC Shkodër. Nga Paneli, Z. Ivan Manzano Barragan, Menaxher i Programit “Shoqëria Civile dhe të Drejtat e Njeriut”, pranë Delegacionit të BE-së në Shqipëri, prezantoi një pasqyrë të përgjithshme të “EU Acquis për barazi dhe mos-diskriminim, duke filluar që me iniciativat më të hershme të shteteve anëtare dhe deri në ditët e sotme, sid eh duke sjellë një panoramë të përgjithshme mbi gjendjen aktuale të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri. Z. Barragan vuri në dukje që ligji shqiptar “Për Mbrojtje nga Diskriminimi” jo vetëm që është në përputhje të plotë me Direktivat e Komisionit European, por në disa aspekte shkon më tej, për sa i përket metodave të implementimit të tij duke përfshirë këtu edhe sanksionet. Gjatë këtij takimi, Znj. Irma Baraku, Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi vuri theksin në rëndësinë e këtij Ligji, si shprehje e respektit për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu ajo njohu të pranishmit me procedurat e ankimimit në raste kur ka diskriminim. Ndërsa, Znj. Vilfrida Bushati, Drejtore e Inspektimit dhe Hetimit pranë Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi, sqaroi fushat që mbulon ligji si dhe detyrimet përkatëse të subjekteve të parashikuara në Ligjin “Për Mbrojtje Nga Diskriminimi”. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 40 përfaqësues nga pushteti lokal, si bashkia, qarku , gjykata e Rrethit Shkodër, Drejtoria Rajonale e Arsimit, përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile dhe pedagogë të Universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe komunitete fetare.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## ***KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI***

Kontributi i Bashkimit Europian në implementimin e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” vijon me organizimin e një *Sesioni Informues mbi Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, në Vlorë pranë zyrave të EUIC në qytet, me datë 16 Qershor.

Komisioneri, duke synuar veçanërisht në edukimin e brezave të rinj pa paragjykime, me datë 20 Dhjetor 2011, ka zhvilluar një takim direkt me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Edit’h Durham”. Gjatë këtij takimi, vëmendja është përqendruar në kuptimin e diskriminimit dhe format e shfaqjes se tij në shkolla si dhe rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në ambientet shkollore. Në asistencën e psikologes, u zhvilluan edhe biseda mes nxënësve dhe Komisioneres mbi problematikat dhe shqetësimet e nxënësve mbi fenomenin e diskriminimit. Komisioneri u shoqërua në këtë aktivitet nga Përgjegjësi i Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun të Zyrës së KMD-së, e cila foli mbi rolin e zyrës për të pritur dhe orientuar publikun për pranimin e ankesave dhe mënyrave të tjera për tu ankuar.

Tryeza e rrumbullakët me temë “*Diskriminimi – Standartet e një gjykimi të drejtë në largimet nga puna, veçanërisht ato të motivuara politikisht*” ishte faza përmbyllëse e projektit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, i cili mundësoi studimin e vendimeve dhe monitorimin e seancave gjyqësore për shqyrtimin e padive për largimet nga puna, si dhe të seancave dëgjimore të Komisionit të Shërbimit Civil dhe mënyrës së si mediat i prezantojnë këto raste. Komisioneri ishte i ftuar në këtë aktivitet duke qenë se fokusi i tij ishte përqendruar në një nga aspektet e diskriminimit që lidhet me marrëdhëniet e punës, ku njerëzit diskriminohen për shkaqe nga më të ndryshmet, si për shkak të gjinisë, moshës, origjinës, bindjeve politike dhe filozofike etj.

Ngritja e vetëdijes për përfshirjen e Romëve dhe egjiptianëve në kuadrin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian ka mbledhur me datë 15 Dhjetor 2011 Komisionin Europian dhe qeverinë shqiptare në seminarin me temë “*Ndërgjegjësimi për përfshirjen e komunitetit Rom dhe Egjiptian në kuadër të Integritit të Shqipërisë në BE*”, organizuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në seancat e seminarit e mori fjalën edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Temat e diskutuara gjatë sesioneve të mbajtura gjatë ditës së seminarit u fokusuan në regjistrimin civil, arsimin, kujdesin social, kujdesin shëndetësor, formimin profesional dhe punësimin, strehimin dhe infrastrukturën. Seminari u fokusua edhe mbi aktivitetet e autoriteteve shqiptare në secilën prej këtyre fushave. Qëllimi i këtij seminari ishte të sjellë së bashku me autoritetet shqiptare, organizatat lokale jo-qeveritare dhe komunitetin ndërkombëtar për të rënë dakord mbi sfidat kryesore me të cilat komunitetet Rome dhe Egjiptiane po përballen në Shqipëri si dhe mbi masat për të lehtësuar përfshirjen e tyre në shoqëri.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



### **3.2. TRAJNIME PËR TARGET GRUPE TE VEÇANTA**

Në zbatim të prioriteteve themelore të institucionit të KMD për njohjen, sensibilizimin dhe edukimin në lidhje me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe funksionet e Zyrës, Komisioneri ka realizuar një projekt të rëndësishëm me temë **“Zbatimi i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Sistemin Arsimor”**, në bashkëpunim me UNICEF.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të fushatës së ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin, nëpërmjet këtij projekti i është drejtuar sistemit arsimor ku përfshihen drejtorët e shkollave publike dhe jopublike si dhe psikologët e shkollave në lidhje me diskriminimin, konceptet, shkaqet, format e shfaqjes së tij si dhe rolin e tyre në zbatimin e ligjit ku përfshihet rritja e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda institucionit; lufta kundër modeleve të sjelljes diskriminuese që përbëjnë ose nxisin diskriminim; trajtimi efektiv i ankesave për diskriminim në institucion sipas afateve ligjore dhe vendosja e masave disiplinore për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi si dhe masa të tjera të përcaktuara në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Qëllimet e projektit:

1. Informimi, sensibilizimi, ndërgjegjësimi dhe njohja me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, konceptin e diskriminimit dhe barazisë, format e shfaqjes së diskriminimit në fushën e arsimit, kompetencat e Komisionerit, roli i tij si dhe mundësitë e tjera që ofron ky ligj për t’u mbrojtur nga diskriminimi
2. Evidentimi dhe trajtimi i rasteve të diskriminimit që shfaqen në shkolla nga drejtuesit e institucioneve arsimore, psikologët dhe mësuesit.

Projekti u realizua me qëllim rritjen e kapaciteteve të drejtuesve të shkollave dhe psikologëve për trajtimin e ankesave për diskriminim në institucionet arsimore, u zhvilluan trajnime në tre qytete: Shkodër, Vlorë, Tiranë. Faza e trajnimeve përbënte një fazë më vete të projektit, e shtrirë në një periudhë kohore prej 6 javësh me trajnime dy – ditore në tre qytetet e sipërpërmendura.

Aktivitetet ndërgjegjësuere të realizuara në kuadër të këtij projekti janë:

- a) Me datë 14 -15 Nëntor 2001, Sesioni Informues 2 ditor nisi në Shkodër pranë Zyrave të EUIC (Qendra e Informimit të Bashkimit Evropian, Shkodër). Trajnimi përfshiu drejtuesit e institucioneve arsimore publike dhe jopublike, psikologët shkollore, mësuesit, specialistët e drejtorive arsimore dhe nxënësit. Ky aktivitet kishte një interesim të madh dhe mbledhi 109 pjesëmarrës nga rrjeti arsimor i qytetit, nga të cilët 45 drejtorë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit.



## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

- b) Në Vlorë Sesioni Informues u zhvillua me datë 21 - 22 Nëntor 2011, pranë Zyrrave të EUIC (Qendra e Informimit të Bashkimit Evropian, Vlorë). Ky aktivitet pati një interes të madh duke mbledhur së bashku 85 pjesëmarrës nga rrjeti arsimor në qytet dhe u reflektua nga të gjitha mediat lokale elektronike që operojnë në Vlorë. Gjatë këtij takimi Znj. Andrea Chalupova, Përgjegjëse e të Drejtave të Njeriut në Delegacionin e BE-së në Shqipëri, theksoi rëndësinë e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” si një kusht i domosdoshëm, i vendosur nga Bashkimi Evropian, në lidhje me integrimin e Shqipërisë, dhe citoi se “Është e papranueshme në ditët e sotme, që fëmijët të diskriminohen mbi baza gjinore, fetare, etnike apo çdo lloj forme tjetër diskriminimi. Shqipëria duhet të bëjë më shumë për përshtatjen e legjislacionit të saj, me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ne do ta mbështesim me çdo kusht Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipëri”.
- c) Me datë 5- 6 Dhjetor 2011, ky Sesion Informues u zhvillua në Tiranë sërish pranë Zyrrave të EUIC (Qendra e Informimit të Bashkimit Evropian, Tiranë), me të njëjtët target grupe. Aktiviteti në Tiranë mbledhi 86 pjesëmarrës.

Vlen të theksohet se, në ditën e parë të trajnimit, në qytetin e Vlorës dhe të Shkodrës Komisioneri ka realizuar emisione në formatin e një debati televiziv me pjesëmarrjen e drejtorëve të drejtorive arsimore dhe përfaqësues të bashkive dhe OJF-ve. Ndërsa në Tiranë është realizuar një intervistë ekskluzive ku përveç informacionit mbi aktivitetin është zgjeruar biseda edhe në aspekte të tjera të punës së Zyrës së Komisionerit.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit janë shpërndarë Module dhe Broshura Informuese mbi Ligjin dhe Komisionerin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” si dhe janë plotësuar dhe grumbulluar rreth 200 formular ankimi të plotësuar nga nxënësit.

Aktivitet tjetër në aspekt të ndërgjegjësimit të target grupeve të veçanta mund të përmendet edhe Sesioni Trajnues me temë “*Standartet Ligjore Kombëtare dhe Ndërkombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, është zhvilluar nga UNDP Albania në disa qytete të Shqipërisë, si Durrës, Elbasan, Lezhë, Tiranë. Qëllimi këtij Trajnimi ishte njohja dhe informimi i pjesëmarrësve, përfaqësues të pushtetit lokal, në lidhje me miratimin e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” si dhe ngritjen e Zyrës së Komisionerit Për Mbrojtjen nga Diskriminim. Punonjës të Zyrës së KMD dhe ekspertë vendas referuan në lidhje me përmbajtjen e ligjit si dhe të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim sipas kuadrit ligjor vendas dhe atij evropian, duke ilustruar edhe me jurisprudencën e GJEDNJ në këtë fushë.

Gjithashtu, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) më mbështetjen e Civil Rights Defenders ka zhvilluar, me datë 2 Nëntor 2011, seminarin me temë “*Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara me qëllim zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Në këtë seminar, dy punonjës të Komisionerit kanë dhënë kontributin e tyre në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit duke referuar në një cikël trajnimesh në qytete të ndryshme të



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Shqipërisë, drejtuar vetë personave me aftësi të kufizuar për t'i njohur ata me ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim nxitjen që të përdorin në mënyrë sa më eficiente, këto mekanizma që ofron Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke pasur si qëllim ofrimin e asistencës ligjore për personat me aftësi të kufizuara. Objektivi i këtij projekti është njohja me këtë ligj, procedurat që ndiqen në raste të diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar por edhe njohja dhe kuptimi i asaj çfarë përbën diskriminim, mënyrat dhe llojet e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar.

### 3.3. KONFERENCA TE KOMISIONERIT

Komisioneri ka marrë pjesë në Konferencën Akademike Ndërkombëtare të zhvilluar në datat 27 - 30 Maj 2011, në Beograd, me temë *“Identifikimi i të drejtave dhe identitetit: Minoritetet seksuale ne Ballkan”*. Referimi i Komisioneres në këtë Konferencë u përqendrua tek situata e personave me orientim të ndryshëm seksual në Shqipëri si dhe ngritja e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si autoriteti i vetëm përgjegjës në Shqipëri që garanton mbrojtje efektive nga diskriminimi kundrejt grupeve vulnerabël, përfshirë edhe personat me orientim të ndryshëm seksual.

Në kuadër të projektit *“Ndërtimi i qytetarisë aktive në Shqipëri”*, Prezenca e OSBE në Shqipëri organizoi një tryezë të rrumbullakët me datë 6 Dhjetor 2011, në të cilën Komisioneri ishte e ftuar si referuese. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte prezantimi i një raporti vlerësues lidhur me procedurat e zhvillimit të kurrikulës së edukatës qytetare në Shqipëri, i hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Institutin për Zhvillimin Arsimor. Konkretisht, Komisioneri u përqendrua gjatë referimit të saj në rëndësinë e edukimit të shoqërisë për të qenë aktiv në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në tërësi si dhe në raport me zbatimin e ligjit antidiskriminim; në rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj si dhe në adresimin e ankesave pranë Komisionerit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi referoi me datë 15 Dhjetor 2011 në seminarin me temë *“Ndërgjegjësimi për përfshirjen e komunitetit Rom dhe Egjiptian në kuadër të Integritimit të Shqipërisë në BE”*, organizuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

### 3.4. PUBLIKIMI DHE SHPËRNDARJA E MATERIALEVE

Për realizimin e objektivit të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të popullsisë nëpërgjithësi dhe grupeve të interesit nëveçanti, në kuadrin e realizimit të projektit *“Zbatimi i ligjit “Për Mbrojtjen*



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

nga Diskriminimi” në sistemin Arsimor” në bashkëpunimi me organizatën UNICEF dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, janë hartuar dhe shpërndarë këto materiale:

- Broshurë Informative mbi Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në fushën e arsimit (për sistemin arsimor par-universitar).
- Manual Trajnimi për drejtuesit e Institucioneve Arsimore, për Psikologët e shkollave dhe punonjësit Social.

Të dy këto materiale janë shpërndarë në Drejtoritë Arsimore Rajonale Shkodër Vlorë dhe Tiranë (qytet).

Përfitues të drejtpërdrejtë të këtij aktiviteti ishin: drejtuesit e institucioneve arsimore publike dhe jopublike, psikologët shkollorë, mësuesit, specialistët e drejtorive arsimore dhe nxënësit.

Në vazhdim të objektivit për sensibilizimin e komunitetit, në kuadër të projektit “*Diskriminimi: Perceptimi dhe sfidat aktuale*” të realizuar me mbështetjen financiare të OSBE Prezenca në Tiranë, janë hartuar dhe shpërndarë këto materiale:

- Përmbledhje në formë Broshure/ fletëpalosje të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në gjuhët: Shqip, Anglisht, Malazeze, Maqedonisht, Arumune, Greqisht, Rumisht dhe për Personat me Aftësi të Kufizuar në shikim është përgatitur broshura në *Braille*.

Gjithashtu në kuadër të këtij projekti është publikuar dhe shpërndarë Broshura me pamje nga punimet e nxënësve të shkollave 9 vjeçare të përzgjedhura të qytetit të Tiranës, me Titull “Të Ndryshëm por të Barabartë”. Kjo Broshurë u shpërnda gjatë aktivitetëve të Zhvilluara në Shkodër, Vlore dhe Tiranë.

Materiale të tjera të përgatitura nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të publikut, mund të përmendim edhe publikimin dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve të përgatitura nga si dhe posterave me materiale informuese mbi Ligjin dhe institucionin e Komisionerit.

### **3.5. KOMUNIKIMI I ZYRËS ME MEDIAN**

Në shkurt 2011 Komisioneri mori pjesë në emisionin ZIP në Vizion Plus, në të cilin u fokusua vecanërisht në çështjen e familjeve Rome të shpërngulura me forcë nga stacioni i trenit dhe më pas, Komisioneri dha një informacion të përgjithshëm mbi institucionin.

Në Shkurt në UTV, sërish kemi pjesëmarrje të Komisioneres në një intervistë televizive, së bashku me përfaqësues të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## ***KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI***

lidhje me çështjen e familjeve Rome të shpërnguluara me forcë nga stacioni i trenit si dhe bashkëpunimi ndër-institucional për zgjidhjen e saj.

Komisioneri ka dhënë intervista të vazhdueshme ekskluzive në lidhje me informacion të përgjithshëm mbi çështje të diskriminimit dhe institucionin e Komisionerit gjatë muajit Dhjetor 2011 në TV SCAN, Planet TV dhe Ora News.

Komisioneri ka dhënë intervista në televizionet lokale të Shkodres dhe Vlorës, në lidhje me aktivitetin ndërgjegjësuese me temë “Zbatimi i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në sistemin arsimor”, organizuar nga KMD me mbështetjen financiare të UNICEF. Gjatë këtyre intervistave Komisioneri është përqendruar në shpjegimin e aktivitetit të mësipërm. Gjithashtu, në lidhje me këtë tematikë, Komisioneri mori pjesë në Top Channel në emisionin Wake up mbi aktivitetin me UNICEF si dhe mbi situatën e diskriminimit, shkaqet dhe fushat, mënyrës se si ushtrohet e drejta e ankimit në Zyrën e Komisionerit etj.

Gjithashtu, përmendim deklaratën për Shtyp të Komisionerit në lidhje me miratimin më 17 Qershor 2011, të Rezolutës së Këshillit mbi të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi shkeljen e të drejtave të individeve për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Në këtë deklaratë, Komisioneri theksoi se: Shqipëria e mbështet këtë resolute, nëpërmjet së cilës kërkohet nga Komisioni i Lartë i të Drejtave të Njeriut përgaitja e një studimi që do të synojë: - Identifikimin e legjislacionit dhe praktikave diskriminuese dhe të akteve të dhunës bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, - Mënyrën si aktet nderkombëtare mund të mbrojnë komunitetin nga aktet e dhunës. Komisioneri, në kuadrin e plotësimit të 12 Rekomandimeve të BE-së, është pjesë e Grupit Ndërinstitucional për rishikimin e legjislacionit me synim mbrojtjen e të drejtave të Komunitetit LGBT.




Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KAPITULLI IV**

### **NGRITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË PUNONJËSVE TË ZYRËS SË KOMISIONERIT**

#### **4.1. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE**

Struktura dhe organika e institucionit të Komisionerit është miratuar me vendimin nr. 34, datë 20.05.2010 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Struktura e Zyrës së Komisionerit sipas këtij vendimi paraqitet si më poshtë:



Gjatë vitit 2011, janë ndjekur në vijimësi procedurat që parashikon Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, për rekrutimin e punonjësve të Zyrës.

#### **4.2. SEMINARE, KONFERENCA DHE TRAJNIME**

Më datë 24 Maj, 9 dhe 29 Qershor, përfaqësues të Zyrës së Komisionerit kanë marrë pjesë në tre *Workshop*-e të organizuar nga Ministria e Integritimit në bashkëpunim me GTZ. Tema ishte: *Workshop* mbi prioritetet e integritimit në Bashkimin Europian në lidhje me Kapitullin 19: “*Politikat Sociale dhe Punësimi*” të *acquis* së BE-së.



## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka ftuar punonjës të Zyrës së Komisionerit në Konferencën Kombëtare në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave. Qëllimi i Konferencës është të prezantojë Konventën e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe Luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, të nxisë bashkëpunimin mes institucioneve të ngarkuara nga ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” si dhe të ndajë eksperiencat dhe sfidat për zbatimin edetyrimeve të Konventës CEDAW dhe Konventës së KE.

Vizitë studimore në Poloni me datë 21 – 26 Nëntor 2011 e një punonjësi të Zyrës së Komisionerit në kuadër të projektit “Mbështetja e Konventës të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara”. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me zbatimin praktik të Konventës mbi të drejtat e personave me Aftësi të Kufizuara.

Me qëllim Mbrojtjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, përfaqësues nga Zyra e Komisionerit kanë marrë pjesë në këto aktivitete:

- 6- 7 Korrik 2011, Pjesëmarrje e KMD në trajnimin e Grupit Ndërmintor të Punës për Hartimin e Projektligjit për Personat me Aftësi të Kufizuar. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara u nënshkrua nga Shqipëria në Dhjetor 2009 dhe po punohet për ratifikimin e saj. Ndërkaq, ka nisur procesi i përafrimit të legjislacionit vendas në këtë fushë me kërkesat e kësaj Konvente. Për këtë qëllim është ngritur grupi ndërministror i Punës që vepron nën drejtimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, grup në të cilin është përfshirë edhe KMD. Në trajnim u prezantuan gjetjet dhe rekomandimet e raportit mbi vlerësimin e legjislacionit dhe politikave ekzistuese, qasja e Konventës ndaj çështjeve të aftësisë së kufizuar si dhe diskutimi mbi rregullimet që duhen bërë për të përshtatur legjislacionin vendas.
- 16 Shtator 2011 - Tryezë e rumbullakët me temë “Amendimi i ligjeve për përafrimin më Konventën “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”.
- 19 Shtator 2011- Trajtime për monitorimin e zbatimit të Konventës “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”.
- 14 -15 Shtator 2011 - Workshop me temë “Diskutim mbi projekt-ligjin për Personat me Aftësi të Kufizuar”.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Pjesëmarrja e një punonjësi të Zyrës së Komisionerit në Zagreb me datë 28 – 30 Shtator 2011 në Kroaci në një Forum konsultativ dhe Workshop Trajnues me temë “*Konventa e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuar: Forcimi i kapaciteteve për Zbatim dhe Raportim*”.

Pjesëmarrja e një punonjësi të Zyrës së Komisionerit në debatin publik “*Të Drejtat dhe Lirite e Grave në Vendin e Punës*” me datë 28 Shtator 2011.

Vizitë studimore e Komisionerit në Slloveni në datat 18-22 Shtator 2011, në kuadër të zbatimit të projektit “*Mbështetja për funksionimin efektiv të mekanizmave të barazisë gjinore në Shqipëri*”.

Pjesëmarrja e një punonjësi të Zyrës së Komisionerit me datë 30 Shtator 2011 në Workshop-in me temë “*Përmirësimi i sistemit të Ndihmës Juridike, kusht për rritjen e aksesit në drejtësi të personave në nevojë*”.

Trajnimi i Sekretares Arkiv-Protokolli në Seminarin 2-javor teorik-praktik “*Për krijimin, evidentimin, klasifikimin, shërbimin dhe ruajtjen e dokumenteve, organizuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave*” nga data 5 deri në 16 Dhjetor 2011 me qëllim ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë.

Në lidhje me vendosjen e balancave mes legjislacionit dhe politikave përkundrejt njohurive të përgjithshme mbi diversitetin dhe çështjet seksuale, punonjës të Zyrës së Komisionerit morën pjesë në trajnimin e datës 14 dhjetor 2011 me temë, “*Përfshirja e çështjeve LGBT në politikën sociale*” e organizuar nga Ambasada PINK, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit mes Ambasadës Pink dhe institucioneve që kanë rol në drejtimit të respektimit të të drejtave të komunitetit LGBT.

Pjesëmarrja në Konferencën e organizuar me datë 8 Nëntor 2011, në lidhje me prezantimin e raportit paraprak që po përgatitet nga Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim (IDN), në kuadër të projektit “*Vlerësimi i Rolit të Institucioneve të Pavarura në ecurinë e Reformës së Sektorit të Sigurisë në Shqipëri*”. Institucionet e analizuara janë Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Inspektorati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive dhe Avokati i Prokurimeve. Ky studim synon të vlerësojë performancën e Institucioneve të pavarura të Mbikëqyrjes duke u përqendruar në rolin që ato luajnë si pjesë e sistemit të llogaridhënies së institucioneve të sektorit të sigurisë. KMD ka dhënë kontributin e tij nëpërmjet dhënies së informacionit, pjesëmarrjes së takime dhe tryeza të rumbullakëta të vazhdueshme dhe informale.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Pjesëmarrja në Takimin e datës 21.10.2011, që kishte për qëllim prezantimin e Raportit “Progresi i Grave në Botë: Në kërkim të Drejtësisë”, raporti i parë kryesor i UN Women që pas themelimit të organizatës në 2010. Kjo paraqitje synonte të nxiste vetëdijen mbi rëndësinë e aksesit të grave në drejtësi. Raporti merr parasysh arritjen e progresit pozitiv por edhe evidentimin e padrejtësive, dhunës dhe pabarazisë në jetën e tyre në shtëpi apo në punë, në politikë apo në jetën publike.

Pjesëmarrja e dy punonjësve të KMD në trajnimin e datës 3 Nëntor 2011, me temë “Zbatimi i Ligjit “Statusi i Nëpunësit Civil” në Institucionet e Pavarura”, të organizuar nga Komisioni i Shërbimit Civil në bashkëpunim me Organizatën për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Ky trajnim u përqendrua në forcimin e komunikimit me institucionet e pavarura që janë subjekt i ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil” si dhe evidentoi çështje të praktikës së punës së Komisionit të Shërbimit Civil lidhur me procedurat që duhen respektuar gjatë rekrutimit, konkurrimit, periudhës së provës, masat disiplinore, pezullimit, liritimit nga shërbimi civil dhe vlerësimit vjetor të nëpunësve civil nga eprorët direkt, personeli i burimeve njerëzore dhe titullarët e institucioneve të pavarura.

Punonjës të Komisionerit kanë marrë pjesë në një aktivitet të organizuar me datë 13 Dhjetor, nga Ambasada PINK dhe Komuniteti LGBT, në të cilin u prezantuan arritjet e deritanishme të punës së Parlamentit Europian dhe diskutimi lidhur me aktivitetin kryesor që Ambasada PINK dhe Komuniteti LGBT planifikojnë për vitin 2012.

Nëpërmjet projektit “Toleranca dhe diversiteti, parime që garantojnë barazinë e qytetarëve”, i mbështetur financiarisht nga Fondacioni SOROS, është bërë i mundur hartimi i “Planit Strategjik 2012-2015 dhe Planit të Veprimit Për Vitin 2012 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Zyra e Komisionerit ka kontribuon në hartimin e kësaj Strategjie nëpërmjet dhënies së informacioneve, sugjerimeve dhe opinioneve gjatë takimeve konsultative me ekspertin ndërkombëtar dhe kombëtar. Ndërkaq, janë zhvilluar takime dhe tryeza tërumbullakëta me grupin e punës, ku përfshihen stafi i Komisionerit dhe dy eksperte, gjatë gjithë procesit të hartimit të Draft Strategjisë. Në procesin e konsultimeve janë përfshirë edhe institucionet shtetërore si: Këshilli i Ministrave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Institucioni i Avokatit të Popullit, institucioni qendror INSTAT të cilët i falënderojmë për informacionet dhe sugjerimet e adresuara. I gjithë procesi për përgatitjen e “Planit Strategjik 2012-2015 dhe Planit të Veprimit Për Vitin 2012 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është vlerësuar si një aspekt i rëndësishëm edhe për sa i takon ngritjes së kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit nëpërmjet kontributit që ata kanë dhënë në hartimin e saj.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KAPITULLI V**

### **BASHKËPUNIMI ME AKTORËT QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E TYRE NË FUSHËN E DISKRIMINIMIT**

#### **5.1. BASHKËPUNIMIN INSTITUCIONAL**

Në kuadrin e bashkëpunimit institucional Komisioneri tashmë ka të nënshkruara marrëveshjet e bashkëpunimit me këto institucione shtetërore:

##### **1. KMD - Komisioni Ndërshtetëror i Ndhmës Juridike**

Në kuadër të objektivit të vendosjes dhe rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional, Komisioneri ka nënshkruar me datë 1 Prill 2011 marrëveshjen e bashkëpunimit me Komisionin Ndërshtetëror të Ndhmës Juridike. Qëllimi i këtij memorandum bashkëpunimi është rritja efektive e mbështetjes dhe ndihmës juridike falas për shtresat vulnerabël të popullatës të prekura nga diskriminimi.

##### **2. KMD – Ministria e Drejtësisë**

Bashkëpunimi i ndërsjellëdo të realizohet kryesisht në shkëmbimin e kuadrit ligjor apo shkëmbimin e ekspertizës për përmirësimin e legjislacionit ekzistues, me qëllim përfshirjen e masave të reja që garantojnë trajtimin e barabartë dhe eliminimin e parashikimeve diskriminuese nga legjislacioni aktual.

##### **3. KMD - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**

Bashkëpunimi me këtë Ministri do të konsistojë në mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e shanseve të barabarta dhe familjes, mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit; mbrojtjen nga diskriminimi të personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri si dhe mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e mbrojtjes shoqërore.

##### **4. KMD – Drejtoria e Pergjithshme e Policisë së Shtetit**

Ky bashkëpunim do të përfshijë Shkëmbim ekspertize dhe angazhim reciprok për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushat respektive; Organizim i fushatave të përbashkëta sensibilizuese dhe trajnimeve, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen nga diskriminimi në shërbimin policor; Bashkëpunim i ndërsjellë me synim evidentimin e problemeve të



## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

personave që janë ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit si dhe marrjen e masave pozitive etj.

Në kuadër të objektivit të vendosjes dhe rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional, Komisioneri është në fazat përfundimtare konsultimi / nënshkrimi i marrëveshjeve të Bashkëpunimit me:

- Ministrinë e Brendshme
- Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës
- Departamentin e Administratës Publike
- Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Gjithashtu, Komisioneri ka kërkuar vendosjen e bashkëpunimit me këto institucione:

- Gjykatat e Rretheve Gjyqësore në Shqipëri
- Ministritë e tjera (përveç atyre të siperpervendura) që kanë detyrime në bazë të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”
- Institucione të tjera të Administratës Publike (si Avokati i Popullit, INSTAT, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave personale etj) me të cilët është i nevojshëm bashkëpunimi me qëllim zbatimin e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”
- Bashkisë Elbasan

Me të gjitha këto institucione janë shkëmbyer Draft Marrëveshjet e Bashkëpunimit, për dhënien e sugjerimeve si dhe plotësimin e mëtejshme sipas kompetencave respektive të subjekteve të përfshira në këto marrëveshje.

### **5.2. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT JO-FITIMPRURËSE**

Në kuadrin e bashkëpunimit me Organizatat Jo-Fitimprurëse, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi me:

- Komitetin Shqiptar të Helsinkit;
- Fondin për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Shqipëri (ADRF Albania)

Përveç marrëveshjeve të bashkëpunimit të vlerësuara si një hap mjaft i rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve reciproke, Komisioneri dhe organizatat jo-fitimprurëse kanë bashkëpunuar edhe në forma të tjera. Në këtë kontekst, theksojmë se një rol mjaft të rëndësishëm në kuadër të kësaj forme bashkëpunimi kanë luajtur edhe organizatat jo-fitimprurëse në Shqipëri që kanë në objekt të punës së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky bashkëpunim është



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

realizuar në disa forma, të cilat kryesisht kanë pasur si objektiv zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe ngritjen së kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit.

Për bashkëpunime konkrete me organizatat jo-fitimprurëse si Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Komuniteti LGBT dhe Ambasada PINK etj referojuni kapitujve më sipër<sup>20</sup>.

### **5.3. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE**

Në lidhje me bashkëpunimin në rang ndërkombëtar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është në proces për përfshirjen e këtij institucioni në EQUINET, Rrjeti European i Organeve të Barazisë.

Komisioneri ka marrë pjesë si vëzhgues në Mbledhjen Vjetore të Përgjithshme të EQUINET në datën 29 – 30 Nëntor 2011.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit si koordinator i procesit të integritimit europian të Shqipërisë, do të ndjekë të gjitha mundësitë dhe procedurat e parashikuara në mënyrë që Shqipëria të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi me BE në mënyrë që të marrë pjesë në Programet PROGRESS të Komisionit Europian, mbi bazën e të cilit është themeluar EQUINET. Programi PROGRESS është një instrument financiar për mbështetjen e zhvillimit dhe koordinimit të politikave të BE në fushat e punësimit, përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, kushteve të punës, mosdiskriminimit dhe barazisë gjinore.

Rregullorja e Programit PROGRESS e kufizon qëllimin e anëtarësimit në këtë organizëm duke qenë se ajo lejon pranimin si Anëtar vetëm të organizatave të atyre shteteve që janë anëtar të Bashkimit Europian ose me ato shtete të cilat kanë nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me BE për tu përfshirë në Programin PROGRESS.

Për bashkëpunime konkrete me organizatat ndërkombëtare si SOROS Albania, OSBE Prezenca ne Shqipëri, PNUD, UNICEF, Delegacioni i Bashkimit Europian ne Shqipëri etj referojuni kapitujve më sipër<sup>21</sup>.

---

<sup>20</sup>Kapitulli III – Ndërgjegjësimi dhe Kapitulli IV - Ngritja e Kapaciteteve Administrative të Punonjësve të Zyrës së Komisionerit

<sup>21</sup>Kapitulli III – Ndërgjegjësimi dhe Kapitulli IV - Ngritja e Kapaciteteve Administrative të Punonjësve të Zyrës së Komisionerit



## **KAPITULLI VI**

### **TRAJTIMI I ANKESAVE**

#### **6.1. VEPRIMTARIA KONKRETE E KMD BAZUAR NË ANKESA**

Gjatë vitit 2011 pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë ardhur 15 ankesa me pretendim për diskriminim për shkaqe të ndryshme. Nga keto ankesa iu nënshtruan një hetimi nga drejtoria e hetim-inspektimit vetem 8 ankesa, pasi 7 ankesa nuk plotësonin kushtet e nenit 33, pika 4 të ligjit nr. 10221 datë 04/02/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” për t’iu nënshtruar një hetimi të plotë.

Bazuar në ligjin nr. 10221 datë 04/02/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesat i janë nënshtruar procedurave të parashikuara duke filluar me verifikimin e fakteve për pretendimet përkatëse.

Gjithashtu gjatë vitit 2011 kanë përfunduar edhe tre nga çështjet të mbartura nga viti 2011.

Gjithashtu janë identifikuar edhe dy fushat kryesore në të cilat pretendohet për diskriminim sicjanënë punësim dhe të mira dhe shërbime.

Nga 11 ankesa të trajtuara në vitin 2011, ka përfunduar shqyrtimi i 8 rasteve, nga të cilat tre raste nuk ka patur diskriminim, një rast Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi ka dalë me rekomandim, dy raste nuk janë shqyrtuar për arsye se ngjarjet që perbejne thelbin e ceshtjes kanë ndodhur pas hyrjes ne fuqi te ligjit nr. 10221 datë 04/02/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, 1 rastështë bërë pushimi i çështjes për mungese provash dhe nje rast për mungese të prokurës nga shoqata që ka bërë ankesen si dhe me kërkesë të shoqates për të pushuar çështjen. Tre ankesa janë duke u shqyrtuar.<sup>22</sup>

Gjithashtu bazuar ne nenin 32 te ligjit nr. 10221 datë 04/02/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nisur nga nje informacion i besueshem ardhur prane zyres se Komisioneritne datën 10.10.2011, sipas së cilit pretendohet diskriminimi i disa fëmijëve romë nga drejtuesit e shkollës 9-vjeçare ”Bajram Curri”, vendosi te ndjekë kryesisht çështjen në fjalë.

**1. Ankesa e ardhur me datë 23/11/2010 ka subjekt një shtetas shqiptar ish-punonjës i Policisë së Shtetit i cili pretendon se është diskriminuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.**

<sup>22</sup> Për informacion më të hollsishtëm referojuni Shtocës Nr. 3

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Ankuesi është larguar nga institucioni i Policisë së Shtetit me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik. Pas kësaj, ankuesi ka paditur pranë gjykatës, Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit, ku objekti i padisë ka qënë konstatimi i pavlefshmërisë absolute të këtij urdhëri. **Me vendim gjyqsor te formës së prerë ankuesi ka fituar te drejtën e kërkuar dhe gjykata ka vendosur;**

- **Anullimin tërësisht të urdhërit administrative objekt gjykimi dhe detyrimin e palëve të paditura, për marrjen e masave për rivendosjen e të drejtës së cënuar.**

Në zbatim të vendimit gjyqsor të formës së prerë është nxjerrë Urdhëri i Ekzekutimit për këtë vendim, urdhër, i cili nuk është ekzekutuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

**Moszbatimin e këtij urdhëri të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ankuesi e konsideron diskriminues, ndërkohë që thekson faktin se “është ushtruar diskriminim pa shkak apo për ndonjë shkak të fshehtë që mua nuk më deklarohet”.**

Në përgjigje të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërmat a) dhe c) dhe nenin 33 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme, si dhe zbatoi të gjitha procedurat ligjore për zbardhjen e çështjes.

Pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të disponuara nga Komisioneri, informacionit, shpjegimeve, akteve e dokumentacionit të paraqitur nga ana e subjektit ankues dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, mbështetur në rezultatet e hetimit administrativ dhe seancës dëgjimore të kryer nga strukturat përkatëse të Komisionerit, me palët, rezultoi se :

- Nuk evidentohen shkaqet e diskriminimit. Gjatë gjithë procedurës shqyrtuese dhe hetimore të ndjekur nga Komisioneri, nga ana e subjektit ankues është pohuar se nuk kishte dijeni mbi këto shkaqe, të cilat ishin të pidentifikuara nga ana e tij.
- Nuk ka prova që vërtetojnë “*trajtimin e ndryshëm në kushte të njëjta*”, të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në mënyrë që të evidentohet diskriminim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë ndaj subjektit ankues. Rastet e paraqitura nga ana e tij, lidhur me punonjës të tjerë të policisë të liruar nga detyra, përbëjnë “*trajtim të ndryshëm në kushte të ndryshme*”.

***Për këto arsye, në bazë të nenit 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi konstatimin e mosdiskriminimit në veprimet e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ndajankuesit P. M.***



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

**2. Ankesa e ardhur me datë 07/12/2010 është paraqitur nga LGBT PRO/PINK Embassy dhe Aleanca Kundër Diskriminimit të personave LGBT, dhe pretendon diskriminim nga nënkryetari i Komisionit Parlamentar të Punës Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë për konsideratën e shprehur ndaj këtij komuniteti si dhe nga Komisioni Parlamentar i Punës Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë për mosmarrjen parasysh të kërkesës së kësaj shoqate ne një seancë dëgjimore të këtij komisioni.**

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32-33 të Ligjit nr. 10 021, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndoqi procedurat përkatëse për trajtimin e ankesës së sipërpërmendur duke njoftuar subjektet për ankesën.

Ne përgjigje të kërkesës së Komisioner Z. Tritan Shehu i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me informacionin shpjegues, ndërsa **Komisionit Parlamentar të Punës Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë nuk i është përgjigjur kërkesës së Komisionerit për të dhënë shpjegime rreth çështjes siç parashikon ligji.**

Pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të disponuara nga Komisioneri, informacionit, shpjegimeve, akteve e dokumentacionit të paraqitur nga ana e subjektit ankues dhe Z. Tritan Shehu si dhe:

- Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 18 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10 021, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe Rekomandimin<sup>23</sup> nr. 11, të Komisionit Europian, të inkorporuar në Progres-Raportin e KE-së për vitin 2010, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese, sidomos për sa i përket komunitetit LGBT, në Shqipëri.
- Duke marrë parasysh involvimin direkt që përfaqësuesit e LGBT PRO/PINK Embassy kishin në këtë çështje, numrin të konsiderueshëm të të infektuarve me HIV-AIDS, si pasojë e transmetimit homo-bioseksual të virusit, si dhe dëshirës që ata kishin shfaqur për pjesëmarrje në këtë seancë dëgjimore, pasqyruar në kërkesën drejtuar Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë.

<sup>23</sup>Progres-Raporti i KE-së për vitin 2010, Rekomandimi 11- Forcimi i mbrojtjes së drejtave të njeriut :

“Të bëhen hapa konkretë në forcimin e mbrojtjes e të drejtave të njeriut, sidomos të grave, fëmijëve dhe romëve, si dhe në zbatimin e efektshëm të politikave anti-diskriminim.”



## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

*Duke patur në vëmendje:*

- Nenin 36, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se : **“Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim”**.
- Nenin 73, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: **“Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe për votat e dhëna prej tij.”**, sikurse edhe nenin 4, pika 3, të ligjit nr. Nr.8550, datë 18.11.1999, “Statusi i Deputetit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: **“Deputeti ka të drejtë të shprehë lirisht mendimet e tij, (...).”**

Mbështetur në nenin 32, gërma (f) të Ligjit nr. 10 021, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht **kompetenca e Komisionerit për të kryer rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin**, si dhe duke patur si qëllim në vetëvete mirëbesimin dhe krijimin e marrëdhënieve sa më normale, të mbështetura në parimin e barazisë dhe aspak diskriminuese, ndërmjet Komunitetit LGBT dhe institucioneve shtetërore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rekomandoi:

- **Evitimin e deklaratave me nota diskriminuese në të ardhmen, të cilat ndikojnë në krijimin e një atmosfere të tensionuar dhe jo miqësore me komunitetin LGBT në Shqipëri.**
- **Dhënia e të gjitha garancive të mundshme që mendimi, opinionimi dhe fjala e tyre të dëgjohet vlerësohet dhe të merret në konsideratë, kur ata janë të involvuar në mënyrë direkte në çështje të caktuara për të ndihmuar këte komunitet te gëzojë normalisht te drejtat dhe liritë e tyre.**

**Në vijim të renditura, ankesat e ardhura pranë zyrës së Komisionerit gjatë vitit 2011:**

1. **Ankesa e paraqitur nga A. P. përfaqësuese e Unionit “Amaro Drom”, me datë 28 Mars 2011 drejtohej kundrejt disa të rinjve nga stacioni i trenit, ku dy prej tyre të ndaluar nga Policia të cilët kanë ushtruar dhunë kundrejt banorëve të komunitetit rom pranë stacionit të trenit. Ankesa pretendon diskriminim për shkak të etnisë kundrejt këtij komuniteti.**



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Bazuar në të dhënat e paraqitura në ankesë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pas marrjes së ankesës dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, vlerësoi se, në bazë të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa nuk mund t’i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm nga ana e Institucionit sipas procedurave të përcaktuara në nenin 33, pika 2 te ligjit: “Organizata me interesa legjitimë paraqet prokurë të posaçme për të përfaqësuar personin ose grupin e personave”.

Sa më sipër bazuar në nenin 33, të ligjit 10 221, datë 04, 02,2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” si dhe me kërkesës të vetë shoqatës, **kjo çështje u pushua për shkak të heqjes dorë të Shoqatës nga ky ankim.**

### ***2. N.T. ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankesën nr. 6, datë 30.03.2011, ku pretendohet për diskriminim të tij, nga policët e Komisarariatit të Policisë nr. 3, Tiranë.***

Në ankesën e N.T, pretendohet se në datën 28.03.2011, para drekë, ai ishte keqtrajtuar fizikisht dhe psikologjikisht në rrugë nga një grup të rinjsh.Në të njëjtën ditë, ai është paraqitur pranë Komisarariatit të Policisë nr.3, në Tiranë, për të denoncuar dhunën e ushtruar ndaj tij, ndërkohë që paraprakisht kishte telefonuar për ndihmë në numrin 129 me anë të telefonit celular me numër 0683649399, por nga ana e policisë nuk ka patur asnjë reagim.Edhe pas paraqitjes së tij në Komisariatin e Policisë nr. 3 në Tiranë, denoncimi i tij jo vetëm që nuk ishte marrë parasysh, por punonjësit e këtij Komisaritati janë tallur me të duke përdorur fjalë fyese.

Në përgjigje të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar ne nenin 32, pika 1, gërmat a) dhe c) dhe nenin 33 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme, si dhe zbatoi të gjitha procedurat ligjore për zbardhjen e çështjes.

Pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të disponuara nga Komisioneri, përpjekjeve të vazhdueshme për të kontaktuar me ankuesin si dhe në bazë të nenit 102 të Kodit të Procedurave Administrative, nenin 32, gërmat a) dhe c) dhe nenin 33, pikat 10 dhe 16, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke qenë se nuk disponohen prova të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e N.T., i cili prej disa kohësh nuk I është përgjigjur kërkesave te Komisionerit, si dhe duke mos patur mundësi të tjera për të hetuar mbi këtë ankesë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi:

1. Të mbyllen procedurat hetimore për ankesën e N.T.
2. Të pushohet shqyrtimi i ankesës së N.T.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

3. Në datën 18/05/2011, S. Ll. ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankesën nr 8, datë 18/05/2011, me pretendimin se është diskriminuar në përzgjedhjen e kandidatëve për punësim në sistemin arsimor, nga DAR (Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë).

Pas paraqitjes së ankesës, u ndoqën procedurat e parashikuara në nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ku rezultoi se në përzgjedhjet për punësime në këtë institucion zbatohet udhëzimi nr 22 dt 29/07/2010, “Për emërtimin e personelit mësimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar” i cili në pikën 6, të udhëzimit ndalon marrjen në punë të personave të cilët i kanë mbaruar studimet me kohë të pjesëshme siç disponon diplomën S.Ll. Për këtë arsye S.Ll. nuk është përzgjedhur dhe nuk ka asnjë shkak ose motiv tjetër siç pretendon ai. Gjithashtu nuk rezultoi asnjë person i punësuar me kohë të plotë në periudhën e pretenduar.

**Për këto arsye, në bazë të nenit 32, pika 1 gërmat a) dhe c), si dhe nenit 33, pikat 10 dhe 16, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi konstatimin e mosdiskriminimit në veprimet e kryera nga Subjekti DAR-Tiranë Qark, ndaj ankuesit S.Ll. për ankesën e dt 18/05/2011.**

4. A.M dhe J.Ç. kanë paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankesën nr.14, datë 25/10/2011, ku pretendohet për diskriminim e tyre nga efektivet e Komisarariatit Nr.1 të Policisë Tiranë, për shkak të orientimit seksual. Sipas ankuesve më datë 19/10/2011 rreth orës 00:05 pas një konflikti të ndodhur mes familjarëve të A.M dhe personave A.M dhe J.Ç., këta të fundit kanë njoftuar Policinë e Shtetit.

Subjektet ankuese paraqesin këtë ankesë pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me pretendimin se janë diskriminuar nga efektivet dhe Shefi i Komisarariatit nr.1 të Policisë Tiranë për shkak të orientimit të tyre seksual.

Në përgjigje të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërmat a) dhe c) dhe nenit 33 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, po ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme, si dhe po zbaton të gjitha procedurat ligjore për zbardhjen e çështjes.

Po analizohen dhe shqyrtohen të gjitha provat, informacionet e grumbulluara, shpjegimet, aktet e dokumentacioni i paraqitur nga ana e subjektit ankues dhe Komisarati Nr.1 të Policisë Tiranë.

*Vazhdon procedura për këtë ankesë.*



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

5. *Ankuesja S.Ç e datëlindjes 27.03.1963 banuese ne Tirane ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr 16 dt 14/11/2011, ku pretendon se diskriminohet nga Z A.K, Drejtor ekzekutiv i Fondacionit "Harry Fultz" dhe znj.B.B, Drejtore e shkolles "Harry Fultz". Pretendohet te jete diskriminuar per shkak te gjinisë .*

Në përgjigje të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar ne nenin 32, pika 1, gërmat a) dhe c) dhe nenit 33 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, po ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme, si dhe po zbaton të gjitha procedurat ligjore për zbardhjen e çështjes.

Po analizohen dhe shqyrtohen të gjitha provat, informacionet e grumbulluara, shpjegimet, aktet e dokumentacioni i paraqitur nga ana e subjektit ankues dhe paleve kundrejt të cilëve është paraqitur ankesa. Eshte planifikuar edhe nje séance dëgjimore me palët.

*Vazhdon procedura per kete ankese.*

6. *Mbështetur në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur në datën 26.10.2011, ankesa e N.Ç. kundër Kryetarit të Bashkisë Kamëz, ku pretendohet për diskriminim për shkak të gjinisë dhe shqetësim seksual në punë.*

Sipas shpjegimeve të dhëna nga znj. Ndriçime Muharrem Çela, ajo pretendon se duke filluar nga data 1 Janar 2010 e në vazhdim në mënyrë të përsëritur i është nënshtruar një sjelljeje diskriminuese nëpërmjet mesazheve në celular, duke u shqetësuar seksualisht në vendin e punës, sjellje të cilat kanë cenuar dinjitetin e saj dhe kanë krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues e ofendues për të, ajo i është nënshtruar një trajtimi të disfavorshëm duke u ulur në detyrë me vendimin nr 1036, datë 30/05/2011 dhe deri pushuar nga puna me Urdhrin nr 292, datë 26/08/2011, si rezultat i mosnënshtrimit ndaj sjelljeve të tilla. Ankuesja pretendon se është viktimizuar, si rezultat i ankesave dhe hapave ligjore të ndërmarra prej saj, për shkak të shqetësimit. Ankuesja ngre pretendimin se për shkak të denoncimit që i ka bërë këtyre rasteve është përballur me një mjedis frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues e ofendues dhe nga punonjësit e tjerë të bashkisë si: mosdhënia e ngarkesës në punë, mbyllja e derës dhe moslejimi i hyrjes në institucion.

Në përgjigje të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar ne nenin 32, pika 1, gërmat a) dhe c) dhe nenit 33 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, po ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme, si dhe po zbaton të gjitha procedurat ligjore për zbardhjen e çështjes.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Po analizohen dhe shqyrtohen të gjitha provat, informacionet e grumbulluara, shpjegimet, aktet e dokumentacioni i paraqitur nga ana e subjektit ankues dhe paleve kundrejt të cilëve është paraqitur ankesa.

Eshte planifikuar edhe nje séance dëgjimore me palët.

*Vazhdon procedura per kete ankesë.*

**7. Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur në datën 01.11.2011, ankesa e A. M. kundër Radio Televizionit Shqiptar, ku pretendohet për diskriminim për shkak të moshës, si kriter për ripunësimin e saj pranë këtij institucioni.**

Sipas shpjegimeve të dhëna nga A. M., rezulton se ajo ka ushtruar profesionin e violinistes pranë RTSH-së, për 12 vjet. Në vitin 2003, ankuesja është larguar në Itali për arsye personale dhe në vitin 2010 është rikthyer në Shqipëri, pas një eksperience 6-vjeçare në Sinfonikën e Romës dhe në Teatrin e San Carlos, në Napoli. Pas kthimit në Shqipëri, A. M pretendon se ka bërë kërkesë për punësim pranë RTSH-së, por përgjigja që ka marrë, me goje, është “*nuk mund të të punësojmë, pasi kemi vendosur limit moshe deri në 30 vjeç*”. Megjithëse kërkesa për punësim është bërë me shkrim nga ankuesja, përgjigja i është kthyer gojarisht.

Në përgjigje të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar ne nenin 32, pika 1, gërmat a) dhe c) dhe nenit 33 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndërromi të gjitha veprimet e nevojshme, si dhe zbatoi të gjitha procedurat ligjore për zbardhjen e çështjes.

Pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të disponuara nga Komisioneri, informacionit, shpjegimeve, akteve e dokumentacionit të paraqitur nga ana e subjektit ankues dhe RTSH, mbështetur në rezultatet e hetimit administrativ Komisioneri per Mbrojtjen nga diskriminimi vendosi:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të A.M, për shkak të moshës, si kriter për ripunësimin e saj pranë këtij institucioni.
2. Konstatimin e parregullsive administrative, lidhur me trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesës për punë të A. M.
3. Meqënëse, konstatimi i kryer në pikën 2 të këtij vendimi, i cili rezultoi si pasojë e kryerjes së procedurës së hetim-inspektimit të ankesës së A.M, me objekt “diskriminim për shkak moshe”, nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.A. M, mund të paraqesë ankim pranë institucioneve kompetente.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

### ***Ankesa qe nuk plotesojne kerkesat e ligjit.***

Gjithashtu prane Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi jane paraqitur edhe 2 ankesa përkatësisht, ankesa e ardhur me datë 23/12/2010 nga ankuesi R. A. qe pretendon se është diskriminuar për shkak të përkatësisë gjinore nga Firma e ndërtimit “Bedhia shpk”si dhe ankesa nr 7, dt. 12.04.2011, ku ankuesi i datelindjes 27/03/1952 me profesion elektrikist banues ne lagjen 5 maj Elbasan ka depozituar ankesen ndaj Drejtorise Rajonale te Sigurimeve Shoqerore Elbasan me pretendimin se ne periudhat 31.12.2004 – 31.07.2005 është diskriminuar si person me aftësi te kufizuar duke mos iu paguar raportet mjekesore si edhe ato te kempit ne peridhat 26.04.2004 – 31.07.2005.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pas marrjes së këtyre ankesave dhe verifikimit të fakteve që lidhen me pretendimin për diskriminim, vlerësoi se, në bazë të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa nuk mund t’i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm pasi sipas nenit 33 pika 4/d të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “ankesa nuk pranohet nëse të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

### **6.2. ÇESHTJA EX-OFFICIO SHKOLLA BAJRAM CURRI**

Bazuar ne nenin 32, pika c, të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kryen hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje te ligjit.

Në datën 10.10.2011, Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi, u njoh menjë informacion, sipas së cilit pretendohet diskriminimi i disa fëmijëve romë nga drejtuesit e shkollës 9-vjeçare ”Bajram Curri”.

Përfaqësuesi i OJF-së ishte në dijeni të fakteve të sipërpërmendura, sepse qendra që ai drejton, shfrytëzon ambientet e kësaj shkolle, për zbatimin e një projekti të mbështetur financiarisht nga UNICEF, në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës e veçanërisht me Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë (DAR), duke asistuar 40 fëmijë romë në shkollën 9-vjeçare “Bajram Curri”.

Nga ana e përfaqësuesit të OJF-sëpretendohet se disa fëmijë romë, të regjistruar për herë të parë (në klasën e parë) në shkollën “Bajram Curri”, janë mbledhur së bashku me grupin e fëmijëve që janë asistuar nga projekti, duke i regjistruar të gjithë në një klasë të parë, të vetme. Kjo, sipas tij është në kundërshtim më Konventën e të Drejtave të Fëmijëve dhe ligjit shqiptar kundër diskriminimit, sepse “segregimi” i tyre për shkak të etnisë dhe problemeve sociale është një akt i dënueshëm dhe nuk ndihmon aspak integrimin e tyre për të cilin synon edhe projekti.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Për këtë arsye, përfaqësuesi i OJFka kërkuar nga institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, marrjen e masave sa më të shpejta për të ndaluar këtë shkelje të të drejtave të njeriut ndaj këtyre fëmijëve romë, duke i vendosur në klasa të ndara dhe jo së bashku me nxënësit e tjerë.

Pas paraqitjes së informacionit nga përfaqësuesi i OJF-së , u hartua dhe u nënshkrua Urdhëri i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio”, të çështjes së fëmijëve romë që janë zhvendosur nga klasat fillestare, ku ishin regjistruar, në një klasë të vetme, në shkollën 9-vjeçare “Bajram Curri”, Tiranë”. Nëpërmjet këtij urdhëri u bë i mundur fillimi i procedurave të shqyrtimit të kësaj çështjeje kryesisht ose me inisiativën e Komisionerit.

Në vijim, Komisioneri iu drejtua Drejtores së Shkollës 9-vjeçare “Bajram Curri”, ku kërkoi informacion lidhur me çështjen në fjalë.

Nëpërmjet shkresave përgjigje, drejtoresha e shkollës na bëri me dije lidhur me faktin se nga 113 nxënës që mësojnë në klasat e para të shkollës 9-vjeçare “Bajram Curri”, 75 prej tyre janë romë dhe pjesa tjetër janë të bardhë. Sipas saj, pas përfundimit të afatit të regjistrimit në datën 10 shtator 2011, Shoqata “Për një vizion bashkëkohor rom” ka kërkuar të regjistrojë pranë kësaj shkolle, disa nxënës që nuk i takonin kompetencës së saj territoriale. Meqënëse, numri i nxënësve të klasave të para u shtua pas kryerjes së këtij regjistrimi, Drejtoresha mori leje nga DAR Tiranë, që të krijonte 4 klasa të para, pasi në datën 7 tetor, kur këta nxënës shtesë u regjistruan, nuk ishte e mundur të bëhëj një rindarje e re. Në këto kushte, klasa shtesë që u krijua kishte vetëm nxënës romë. Sipas saj, regjistrimi i këtyre nxënësve romë, një pjesë e mirë e të cilëve e kishte vendbanimin në Babrru, duhej kryer në shkollat më të afërme me vendbanimin e tyre dhe jo në shkollën “Bajram Curri”.

Nga informacioni i drejtoreshës së kësaj shkolle rezulton se që prej katër vitesh, numri i nxënësve romë në shkollën “Bajram Curri” është rritur me 17%, që do të thotë se 47% të nxënësve të kësaj shkolle janë romë dhe egjiptianë, ose që nga 885 nxënës, 316 nxënës janë romë dhe 89 nxënës janë egjiptianë. Në këto kushte, ajo e mohon të ketë diskriminim të tyre, kur numri i tyre është i konsiderueshëm krahasuar me numrin e nxënësve të bardhë.

Për të kryer verifikime të mëtejshme, lidhur me çështjen në fjalë, në bazë të nenit 32, gërma c u krye inspektimi pranë shkollës 9-vjeçare “Bajram Curri”, Tiranë.

Gjatë inspektimit u konstatua se fëmijët romë, të cilët janë objekt i çështjes, ishin sistemuar në një klasë të parë të vetme. Ata ishin pjesë e projektit “Shansi i dytë”, projekt që zbatohet nga Qendra “Për një Vizion Bashkëkohor Rom”. Shumica e këtyre fëmijëve ishin me vendbanim në çadrat/Babrru dhe në Bregun e Lumit. Sipas drejtoreshës së shkollës, këta nxënës ishin



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



## **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

regjistruar në shkollë pas datës 10 shtator<sup>24</sup> (ekzaktësisht pas datës 01.10.2011), datë në të cilën përfundonte afati i regjistrimit, sipas Udhëzimit nr. 31, datë 04.08.2011, të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës “Për vitin e ri shkollor 2011-2012 në sistemin arsimor parauniversitar”. Sipas drejtoreshës së shkollës, këta nxënës ishin vendosur në një klasë të vetme, për shkak të mbingarkesës në nxënës të klasave të para ekzistuese në këtë shkollë, për shkak të kushteve higjieno-sanitare, si dhe për t’iu përshtatur mënyrës së tyre të frekuentimit të mësimin. Njëkohësisht, fakti i krijimit të kësaj klase të parë nuk kishte pasur si synim diskriminimin e nxënësve romë, por përkundrazi kishte si qëllim faktin që fëmijët romë që ishin pjesë e projektit “Shansi i dytë”, të qëndronin sëbashku me qëllim që njohuritë që do të përfitonin të ishin të të njëjtit nivel, meqënëse këta fëmijë merrnin mësim edhe në kuadër të projektit të sipërpërmendur.

Gjatë inspektimit, inspektorët e Komisionerit kryen verifikime në klasën e parë me fëmijë romë, si dhe asituan disa minuta në mësimdhënie. Këtu, u konstatua fakti se në këtë klasë kishte një numër të konsiderueshëm mungesash nga nxënësit romë, të cilët nuk e frekuentonin rregullisht mësimin. Gjithashtu u vizituan edhe disa klasa të tjera, ku u vu re se numri i nxënësve romë dhe egjiptianë ishte i konsiderueshëm.

Ne bazë të Vendimit nr. 9, datë 30.11.2011 të Drejtoreshës së Shkollës 9-vjeçare “Bajram Burri”, klasa e parë (I-d), e cila kishte në përbërje të saj vetëm fëmijë romë ishte shpërndarë në datën 01.12.2011, si pasojë e pakësimit të numrit të nxënësve që frekuentonin mësimin rregullisht. Fëmijët romë të kësaj klase, tashmë ishin pjesë e tre klasave të para ekzistuese në këtë shkollë. Për këto arsye, në bazë të nenit 32, pika 1, gërmat a), c) dhe ç), si dhe nenit 33, pikat 10 dhe 16, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke qenë se qëllimi kryesor i Komisionerit për zgjidhjen e kësaj çështjeje ishte shpërndarja e klasës së I-d, pranë shkollës 9-tjeçare “Bajram Curri”, Tiranë, e cila kishte në përbërje të saj vetëm fëmijë romë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi:

1. Pushimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes së fëmijëve romë, të vendosur në një klasë të parë, të vetme, pranë Shkollës 9-vjeçare “Bajram Curri”.

---

<sup>24</sup>Ky fakt ishte i pamundur të evidentohet, sepse në shkollën 9-vjeçare “Bajram Curri” nuk administrohej një regjistër fillestar regjistrimi, ku të rezultonin datat e regjistrimit të nxënësve të klasave të para.



**KAPITULLI VII**


**ASPEKTE TË SHËRBIMEVE**

**7.1. REALIZIMI I BUXHETIT TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse gjatë vitit 2011 ka pasur në qendër të vëmendjes menaxhimin me efikasitet të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike, të vëna në dispozicion të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në bazë të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” Komisioneri ka buxhetin e vet të pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga donacione të ndryshme.

Për vitin 2011, KMD-së i është akorduar një fond i planifikuar, në fillim të vitit, **prej 42.450 në mijë lekë**, vlerë e cila me buxhetin e rishikuar është **33.430 në mijë lekë**. Në zbatimin e këtij buxheti, KMD është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Grafiku dhe tabela e mëposhtëm paraqesin në mënyrë të detajuar buxhetin e Komisionerit dhe përdorimin e tij për vitin 2010, dhe në mënyrë të detajuar për vitin 2011 sipas tabelës.



## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

### DETAJIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2011

Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca	Vlerat në %
Paga dhe Sigurime Shoqërore	23950	16964.45	6985.55	70.83
Mallra dhe Shërbime të tjera	4980	4949.22	30.78	99.38
Investime	4500	4468.96	31.04	99.31
Transferime korrente	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>33430</b>	<b>26382.63</b>	<b>7047.37</b>	<b>89.84</b>

Komisioneri raporton në Ministrinë e Financave në lidhje me Raport Progresin çdo 3 – muaj, i cili konsiston në Shpenzimet e Komisionerit sipas Planifikimit Vjetor.

Gjatë vitit 2011 një nga detyrat parësore dhe prioritare ka qenë ndjekja e realizimit të procedurave të prokurimeve në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi me qëllim mundësimin e zhvillimit të një aktiviteti normal të punës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të punës, plotësimin e nevojave të punonjësve me pajisjeve. Në këtë drejtim zyra e Komisionerit ka realizuar tre procedura prokurimi si me poshtë:

- Rikonstruksionin e Zyrave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Blerje mobiliesh
- Blerje pajisje kompjuterike (informatike)

Gjithashtu është hartuar Projekt Buxheti Afatmesëm 2012 -2014 në përputhje me objektivat e punës të vendosura për këto vite.

Për vitin në vazhdim do të zbatohet me korrektësi treguesit e buxhetit të planifikuar për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke synuar maksimizimin e efektivitetit të shpenzimeve në funksion të rritjes së kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

**KAPITULLI VIII**

**STRATEGJIA PËR VITIN 2012 DHE PLANET PËR PERIUDHEN NË  
VAZHDIM**

**8.1. PLANI STRATEGJIK 2012-2015 DHE PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2012 I  
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE OBJEKTIVAT  
STRATEGJIKE PËR VITIN 2012**

Puna e bërë gjatë vitit 2011 si dhe objektivat e realizuara do të shërbejnë si mbështetje e mëtejshme për zbatimin e objektivave për vitin 2012 të Komisionerit në fushën e mbrojtjes nga diskriminimit dhe çdo formë tjetër sjellje që nxit diskriminimin.

Me kalimin e më shumë se një viti nga hyrja në fuqi e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe nga fillimi i punës së KMD-së, ishte i nevojshëm hartimi i një Plani Strategjik për institucionin që të përcaktonte vizionin, qëllimet dhe objektivat konkrete për veprimtarinë e ardhshme të Komisionerit. Në këtë kontekst, u hartuar Plani Strategjik 2012-2015 dhe Plani i Veprimit për vitin 2012 për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Hartimi i këtij dokumenti u mbështetet në një proces konsultues transparent dhe gjithëpërfshirës, si me përfaqësues të institucioneve shtetërore qendrore, organizatat e shoqërisë civile, ashtu edhe me komunitetin e donatorëve. Objektivi i këtij dokumenti është përcaktimi i një strategjie për zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për vitet 2012-2015, si dhe përcaktimi i detajuar i Planit të Veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2012. Ky Plan Strategjik dhe veçanërisht Plani i Veprimit për vitin 2012 do të përbëjë një instrument për KMD-së për realizimin e sfidave që shtrihen përpara tij për vitin 2012 dhe përballimin e tyre.

I udhëhequr nga vizioni :

***“Të jetojmë në një shoqëri ku respektohet parimi i barazisë dhe promovohet barazia e shanseve dhe mundësive”***

misioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të garantuar ***mbrojtjen efektive nga diskriminimi i të gjithë personave të parashikuar nga ligji***, do të realizohetpërmes:

- Ofrimit të ndihmës së pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin;



## ***KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI***

- Rritjes së ndërgjegjësimit nëpërmjet informimit për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi, për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje dhe zhvillimit të dialogut të rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë dhe organizatat joqeveritare;
- Kryerjes së sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin si edhe
- Publikimit të raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.

Veprimtaria e KMD-së për vitin 2012 bazuar edhe në Planin e Veprimit për 2012 do të udhëhiqet në realizimin e këtyre objektivave:

- **Rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi dhe rolin e KMD-së në këtë fushë;**
- **Rritjen e numrit të ankesave drejtuar KMD-së;**
- **Organizimin e përshtatshëm institucional me qëllim rritjen e efikasitetit të zyrës së KMD-së;**
- **Konsolidimin i rolit të KMD-së në sektorin publik dhe privat.**

Të gjithë këto objektiva janë në funksion të sfidës kryesore për KMD-në që është:

***Njohja dhe krijimi i integritetit të autoritetit publik të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.***



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

***KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI***

**SHTOJCA NR. 1**

**Tabela me Fushat dhe Shkaqet e Diskriminimit**




Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)




SHTOJCA NR. 2

SONDAZH MESUESIT TOTAL




## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



A keni dijeni per krijimin e Zyres se Komisionerit per  
Mbrojtejen nga Diskriminimi



A vini re shpesh sjellje diskriminuese ne ambientet  
shkollore?




## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI





## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI


### Cilat mendoni se jane shkaqet e diskriminimit ne ambientet shkollore



## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI





## Sondazh nxënësit total






## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



**A vini re shpesh sjellje diskriminuuese ne ambjentet shkollore?**


Asnjehere  
25%





Preferoj te mos ta them  
8%

**A eshte sjelle dikush ndaj jush ne menyre diskriminuuese?**


Nuk e di  
10%



## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI




## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI




**SHTOJCA NR. 3**

**ANKESA TE TRAJTUARA GJATE VITIT 2011  
GJITHSEJ 18 ANKESA**




**ANKESA TE SHQYRTUARA DHE ANKESA  
QE NUK JANE PRANUAR**



## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

### KLASIFIKIMI I ANKESAVE TE SHQYRTUARA NE VITIN 2011 SIPAS SHKAQEVE TE DISKRIMINIMIT.

TOTALI 11 ANKESA



### PERFUNDIMET E ÇESHTJEVE TE TRAJTUARA NE 2011

GJITHSEJ 8 ÇESHTJE

